



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË
(2022)



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-548 644 URL: fn.uni-pr.edu e-mail: fn@uni-pr.edu

Dekani
Prof.Ass.Dr.Florim Grajçevci

Ref. nr. _____

Prishtinë _____ 2022

**RAPORT I VETËVLERËSIMIT
RIAKREDITIMI I PROGRAMEVE STUDIMORE**

Hartues:

Prof. ass.Dr. **Florim Grajçevci**, Dekan

Prof. ass. Dr. **Hajdar Sadiku**, Prodekan

Prof. ass. Dr. **Ymer Kuka**, Prodekan

Ass. MSc. **Enes Krasniqi**, Koordinator për zhvillim akademik

Bartësit e programeve studimore:

Prof. asoc. Dr. **Përparim Ameti**, programi Master Gjeodezi

Për hartimin e raporteve të vetëvlerësimit kontribuan i gjithë stafi akademik i FN-së.

Prishtinë, Janar 2022

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

PROGRAMI I STUDIMIT:

GJEODEZI (MSc)

RIAKREDITIM

RAPORT VETËVLERËSIMI

Janar 2022, Prishtinë

Tabela e përmbajtjes:

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË	3
1. HYRJE	5
1.1. Një vështrim i shkurtër i Institucionit.....	5
1.2 Një vështrim i shkurtër i programit në vlerësim – Gjeodezi	10
2 VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT GJEODEZI (MScGJ)	13
2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi.....	13
Analiza SWOT-it për misionin, objektivat dhe administratën:	18
2.2. Menaxhimi i cilësisë.....	19
Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:	22
2.3. Stafi akademik	23
Analiza SWOT për stafin akademik:.....	26
2.4. Përmbajtja e procesit arsimor	26
Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit mësimor:.....	32
2.5. Studentët	33
Analiza SWOT për studentët:	36
2.6. Hulumtimi.....	37
Analiza SWOT për hulumtim:	39
2.7. Infrastruktura dhe burimet.....	40
Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:	43
3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM	44
4. LISTA E REFERENCAVE	49
5. SHTOJCAT	51
5.1. Studentët – të dhënat	51
5.2. Hapësirat dhe paisjet	52
5.3. Plani i Buxhetit dhe financimi për FN dhe FA.....	54
5.4 Struktura e Anekseve të bashkelidhura në format elektronik (për verzionin final të RVV-se në CD)	55

1. HYRJE

1.1. Një vështrim i shkurtër i Institucionit

Fakulteti i Ndërtimtarisë (FN) është njësi akademike e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" institucion publik i arsimit të lartë, i cili zhvillon dhe organizon programe të studimeve universitare, punën e lartë shkencore dhe profesionale. Roli kryesor i një njësie akademike moderne për shoqëri demokratike është që të sigurojë ngritje shkencore dhe arsimore profesionale duke i përcjellë zhvillimet bashkëkohore shkencore në fushat përkatëse të studimeve.

- **Misioni dhe objektivat, programet e studimeve të ofruara**

Misioni i FN-së është i bazuar në misionin e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e veprimeve akademike, hulumtimeve, punës shkencore dhe të krijojë kuadro profesionale të arsimit të lartë për tregun e punës për fushat e inxhinierisë së ndërtimit në pajtim me interesat strategjike dhe zhvillimore të vendit.

Mësimdhënia dhe kërkimet shkencore, paraqesin veprimtarinë kryesore të kësaj njësie akademike. Veprimtarinë e një njësie akademike e karakterizon bashkëveprimi ndërmjet veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore. Kjo, për faktin se, për arritjen e rezultateve të dëshiruara në studime, mësimdhënia duhet të jetë e pa ndarë nga puna kërkimore shkencore.

Në kuadër të aktiviteteve që zhvillon FN-ja, fokusi qëndron në këto orientime dhe arritje:

- mësimdhënie - mësimnxënie, që njëkohësisht numërohet si një nga dy veprimtaritë kryesore,
- kërkime të vazhdueshme shkencore në shërbim të shoqërisë dhe vendit në përgjithësi,
- kuadro profesionalisht kompatible me kërkesat e tregut,
- aktivitete në fusha të nevojshme për kërkesat e tregut dhe
- ofrimi i shërbimeve dhe ekspertizave për palët e treta
- hulumtime në zhvillimin e patentave nga ana e personelit akademik.

Qëllimi i FN-së është që të ketë rol udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë dhe gjithashtu të krijojë dhe të mbështes standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, me fokus permanent në kërkimet shkencore në fushën e inxhinierisë së Ndërtimit. FN-ja kërkon t'u përshtatet Standardeve Evropiane dhe të integrohet plotësisht në zonën Evropiane të arsimit të lartë sipas Deklaratës së Bolonjës.

Vizioni i FN-së është të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë dhe të transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, po ashtu të ofrojë mundësi për të gjithë banorët e Kosovës për të përfituar nga ky arsim gjatë gjithë jetës së mësimin tërë jetësor pa kufizime.

Në këtë mënyrë niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht transferuese në disiplina të përafërta.

Në Fakultetin e Ndërtimtarisë organizohen programe të studimeve të niveleve BSc dhe MSc, ndërsa aktualisht nuk organizohen programe të Doktoratës. Programet e studimeve të klasifikuara të FN-së në Departamente dhe nivele janë sikur:

- Konstruktiv (BSc), dhe (MSc)
- Hidroteknikë (BSc), (MSc)
- Gjeodezi (BSc), (MSc), dhe
- Inxhinieri e Ambientit (BSc)

Programet studimore Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit, në mënyrë të përgjithshme përbëhen nga grupi i lëndëve të përgjithshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale, plotësuese dhe punimi i temës së diplomës të nivelit Baçelor e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.

Tërësia e kredive të parapara për përfundimin e Programeve Baçelor në Departamentet: Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit është grumbullimi i 180 ECTS kredive, përfshirë edhe punimin e diplomës, në kohëzgjatje minimale prej 3 vitesh (6 semestra). Tërësia e kredive të parapara të Masterit në: Gjeodezi, Konstruktiv dhe Hidroteknikë, është grumbullimi i 120 ECTS kredive, përfshirë edhe punimin e Masterit, në kohëzgjatje prej 2 viteve (4 semestra).

- **Udhëheqja, strukturat e menaxhimit, personeli akademik dhe administrata.**

Universiteti i Prishtinës ka Statutin [A1] (shih 06-Aneks-Lista e referencave) ose [S1] (shih vegzën në tabelën me tituj dhe përshkrim të rregulloreve/politikave, në Standardin 1.4), ku përfshihen: njësitë akademike si pjesë përbërëse, dokumente relevante për ndihmesë të njërive akademike, organet kolegjiale duke filluar nga Këshilli Drejtues, Senati, komisionet funksionale të tjera, stafin menaxhues dhe administratën qendrore. Të gjitha këto FN i shfrytëzon për të organizuar dhe zhvilluar veprimtaritë akademike, hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimeve, mësimdhënien dhe mësimnxënien, duke pas në qendër të vëmendjes studentin.

Dekani i Fakulteti i Ndërtimtarisë, sipas statutit të UP-së është udhëheqës i cili krijon një mjedis kolegjial, bashkëpunues dhe studimi që i shërben interesave të përbashkëta të studentëve, profesorëve, stafit menaxherial dhe administrative. Detyrat e dekanit të IAL janë të përshkruara edhe në dokumentet relevante të nivelit qendror të UP-së, (<https://uni-pr.edu/desk/inc/media/126A0EED-0A53-48A7-8E56-5875EE868FAC.pdf>) [A6] (shih 06-Aneks-Lista e referencave). IAL, përkatësisht FN ka një strukturë të ndërtuar dhe të qëndrueshme të menaxhimit. Janë të zgjedhur dy anëtar nga stafi akademik me kontratë të rregullt pune në cilësinë e prodekanit. Prodekanët kanë detyrat e ndara dhe të përcaktuara mirë. Njëri nga prodekanët është përgjegjës për fushat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, çështjeve organizative me studentë dhe çështjeve organizative të njësisë akademike ndërsa prodekanit tjetër është përgjegjës për çështjet financiare dhe infrastrukturën e institucionit. Mbështetur në Statutin e UP-së, Dekani organizon departamentet të cilat marrin përgjegjësitë nga Dekani dhe sipas dokumenteve relevante të UP-së dhe të FN-së.

Në kuadër të FN-së ekzistojnë Departament të cilat korrespondojnë me fushat e studimeve përkatëse me programe studimore të veçanta të nivelit Baçelor dhe Master shkencor. Departament e FN-së, janë <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,31>:

- Departamenti i Konstruksioneve,
- Departamenti i Hidroteknikës,
- Departamenti i Gjeodezisë, dhe
- Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit

Funksionimi i departamenteve, në vijën vertikale nënkupton pjesëmarrjen e stafit akademik në vendimmarrje deri te Këshilli i njësisë akademike përkatësisht Dekanit të fakultetit. Për kompetencat e FN nga UP-ja vendimet merren në Këshillin e Fakultetit përkatësisht Dekani i Fakultetit.

Administrata e UP-së është e centralizuar dhe ofron shërbim të gjitha njësive akademike lidhur me shumë çështje, sikur mund të numërohen disa nga to: financat, shërbimet për studentët (diplomat, etj.), kontratat e personelit akademik dhe administrativ. Administrata e Fakultetit është me kompetenca të kufizuara ekzekutive dhe për Fakultetin e Ndërtimtarisë ajo përbëhet nga Sekretari, si funksioni më i lartë dhe përgjegjës për administratën në nivel të njësive akademike, shërbimi për studentët, TI -personeli, ekonomisti – financieri, shërbimi i protokollit, menaxheri i aseteve dhe laborantëve.

- **Studentët, fushat përkatëse të veprimtarisë së institucionit**

Fakulteti i Ndërtimtarisë ofron programe të studimeve baçelor BSc për fusha të ndryshme të studimeve (Konstruksione, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit), mbështetur në Statutin e UP-së dhe sipas KKK Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (https://akkks.rks.gov.net/uploads/korniza_kombetare_e_kualifikimeve_2020.pdf), që ju dedikohen kandidatëve nga Republika e Kosovës të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm sipas kornizës nga MASHT-i për arsimin e mesëm dhe kandidatëve nga vendet tjera sipas kotave të aprovuara <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/AEE5CABB-5CD7-4418-9489-03949385902A.pdf>. Për regjistrimin e studentëve të ri në programet e studimeve themelore në FN, shpallet konkursi nga UP-ja <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/308524D5-4D04-418C-B904-A574F890E195.pdf> duke specifikuar të gjitha kriteret dhe kuotat. Pas shpalljes së konkursit, FN-ja organizon provimet sipas kritereve dhe vlerëson provimet, suksesin nga shkolla e mesme, provimi i maturës dhe bënë rangimin e tyre duke i shpallë në faqen elektronike të fakultetit si dhe në hapësirat adekuate të sajë.

IAL organizon programe të studimeve edhe të niveleve Master shkencorë nga fushat e njëjta të programeve të studimeve nga BSc (Konstruktiv, Hidroteknikë dhe Gjeodezi). Programet e studimeve ju dedikohen studentëve të cilët kanë përfunduar studimet themelore dhe që kane mbërritur numrin e kredive prej 180 ECTS nga studimet BSc të fushave përkatëse. Për regjistrimin e studentëve të ri në programet e studimeve Master gjithashtu shpallet konkursi publik nga Universiteti i Prishtinës ku specifikohen të gjitha kriteret dhe kuotat. Pas shpalljes së konkursit, FN-ja organizon provimet sipas kritereve dhe vlerëson provimet, suksesin nga niveli i studimeve themelore, dhe bënë rangimin e tyre duke i shpallë në faqen elektronike të fakultetit si dhe në hapësirat adekuate të sajë.

Fakulteti i Ndërtimtarisë ka rolin kryesor mësimdhënien dhe mësimdhënien, ku gjatë gjithë kohës ka në qendër të vëmendjes studentin. Përsosja e mësimdhënies arrihet përmes punës kërkimore hulumtuese që realizohet nga personeli akademik i IAL-së. Angazhimi i personelit akademik në fushat e hulumtimeve është prezent jo vetëm në vend, mirëpo edhe jashtë vendit duke dhënë kontribut shkencorë në konferenca shkencore me punime shkencore të publikuara edhe në revistat më prestigjioze në botë të fushës. Bashkëpunimet e FN-së me institucionet arsimore në vend dhe jashtë vendit janë inspirim për menaxhmentin dhe personelin akademik, gjithashtu kontributet institucionale dhe të personelit akademik për nevojat e tregut të punës janë evidente dhe numërohen si ngjarje e rëndomtë e Institucionit. Personeli akademik i FN jep kontribut të çmuar për shërbime të ndryshme të Fakultetit sipas kërkesave dhe mund të numërohen disa nga këto punë, sikur është edhe vet Raporti i vlerësimit të programeve të studimeve, hartimi i raporteve dhe analizave të ndryshme për nevojat e fakultetit. Prandaj, menaxhmenti i FN së bashku me stafin akademik dhe administratën janë të angazhuar jo vetëm në procesin e mësimin, mirëpo edhe në ngritjen e performancave të mësimdhënies, mësimdhënies, hulumtimeve shkencore dhe shërbimeve tjera të nevojshme për Institucionin.

- **Mësimdhënia, mësimi dhe kurrikula**

UP siguron studime baçelor, master dhe të doktoratës, sipas sistemit të Bolonjës përmes njësive akademike. Edhe pse Republika e Kosovës ende nuk është formalisht pjesëmarrëse në Procesin e Bolonjës, UP është një nga institucionet e para të arsimit të lartë në regjion që ka filluar reformat sipas këtij Procesi. Implementimi i reformave filloi në vitin akademik 2002/2003 dhe ende vazhdon. UP është i përkushtuar të arrijë objektivat e dala nga Deklarata e Bolonjës dhe deklaratat e komunikatave të Pragës, Bergenit, Berlinit dhe Londrës, dhe ka për qëllim të integrohet në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Universiteti ka rëndësi kryesore si sigures publik i arsimit të lartë në shoqërinë, komunitetin dhe ekonominë e Kosovës

Gjithashtu FN-ja vepron në vazhdueshmëri në fushëvepritaritë e veta si pjesë përbërëse e UP-së të arrijë qëllimet e përgjithshme të përcaktuara qartë.

Misioni i UP-së “për zhvillim të arsimit akademik, hulumtimit shkencor, kreativitetit artistik, këshillimit profesional” është i shoqëruar nga një grup prej 8 objektive të detajuara, që ndikojnë qartazi ambicien e UP-së që të bëhet Universiteti Lider në Kosovë, të jetë aktiv në shoqëri, të krijoj dhe mbaj standardet më të larta në mësimdhënie, dhe mësim dhe hulumtim, dhe të jetë plotësisht i integruar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë si një universitet i njohur ndërkombëtarisht. Fakulteti i Ndërtimtarisë duke qenë pjesë e UP-së dhe pjesëmarrje në veprimet e saja akademike vepron qartazi duke pas të përcaktuar synimet e saja primare për arritshme rinë maksimale në mësimdhënie.

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektive të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.

Mekanizmat e mësimdhënies të cilat zbatohen në Institucion janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë mësimin, përvojës të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të institucionit si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në zbërthimin e fenomeneve shkencore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, ndër të cilat "mësimdhënia një drejti morë" (nga pedagogu te studenti) duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies pedagogun e vejnë në rolin primar jo vetëm të profesorit mirëpo edhe të moderatorit.

Stafi i Pedagogëve përgatitet gjithmonë me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies duke ju ofruar mundësia e pjesëmarrjes edhe nëpër trajnime permanente të ndryshme të organizuara në nivel të Universitetit <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,78>.

Në funksion të formës së zgjedhur të mësimdhënies përcaktohet dhe organizimi i mësimdhënies, nëse ai do të jetë ligjëratë, ushtrime numerike, mësim praktik në terren ose edhe ushtrime laboratorike. Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën mësimore. Rëndësi të veçantë ju jepet lëndëve të cilat ushtrojnë vizitat praktike në terrene si dhe ushtrimeve laboratorike duke demonstruar edhe shembuj praktik nga realiteti.

Veçori e Institucionit është monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimdhënësve gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Këtë monitorim e përcjellë vlerësimi i të gjithë mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit të vlerësuar nga studentët [A52] (shih 06-Ankes-Lista e referencave) ose [U3] (shih vegzën në tabelën me tituj dhe përshkrim të rregulloreve/politikave, në Standardin 1.4.), Përmes instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies arrihet cilësia më e lartë e nxënies.

Secila lëndë mësimore ka literaturën e sajë themelore sipas syll abusit dhe literaturën e obliguar dhe të preferuar të cilën Studenti mund ta gjejë ose mësimdhënësi ju siguron paraprakisht.

Kutikulat e programeve të studimeve si atyre themelore ashtu edhe studimeve mastar kanë koncept përmbajtësor duke pas për bazë parimet themelore të formimit të programit të studimit nga formimi i grupit të lëndëve të përgjithshme informuese, pastaj grupi i lëndëve teorike shkencore si dhe grupi i lëndëve përmbajtësorë të profesioneve të ngushta nga të cilat dalin edhe kompetencat e veçanta të studentëve pas përfundimit të studimeve.

1.2 Një vështrim i shkurtër i programit në vlerësim – Gjeodezi

Emri i Institucionit:	Universiteti i Prishtines “Hasan Prishtina”
Fakulteti/Departamenti:	Fakulteti i Ndërtimtarisë
Kampusi Kryesor dhe/apo Dega:	Kampusi Kryesor
Nëse aplikohet për Degë, ju lutem specifikoni Degën:	NA
Emërtimi i Programit të Studimit:	Gjeodezi
Personi përgjegjës për Programin e Studimit:	Prof.Dr.Asoc. Perparim Ameti
Akreditim/Riakreditimi:	Riakreditim
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Niveli VII
Grada akademike apo emërtimi i gradës akademike në diplomë:	Master i Shkencave në Gjeodezi
ECTS:	120
Profili i programit të studimit (specializimet):	Gjeodezi
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC):	07.6
Forma e studimeve:	Studime të rregullta
Kohëzgjatja minimale e studimeve:	2 vite
Numri i vendeve për studim:	20
Shëno Stafin e përhershëm shkencor/artistik për Programin e Studimit (së paku 3 PhD):	Prof.Asoc.Dr.Perparim Ameti Prof.Ass.Dr. Ymer Kuka

Në kuadër të katër Departamenteve të mbuluara nga Fakulteti i Ndërtimtarisë, përfshihet edhe Departamenti i Gjeodezisë me program të studimit të nivelit Master Gjeodezi (tutje si MScGJ). Politikat dhe procedurat e hartuara dhe të miratuara për të gjitha programet, nga Fakulteti i Ndërtimtarisë janë të zbatueshme edhe për programin e studimit MScGJ. Personeli mësimor i angazhuar në programin e studimit MScGJ është i kualifikuar dhe me përvojë si në mësimdhënie ashtu edhe në hulumtime shkencore për fushën e veçantë për të cilën janë të angazhuar. Si të tillë, mësimdhënësit kontribuojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në përgjithësi, e në veçanti në nxitje të motivimit, e reflektimit në procesin mësimor

Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për ngritje profesionale të fushave të gjeodezisë, gjeoinformacionit dhe vrojtimit të Tokës nga hapësira, ndërsa FN ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund të shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Kjo jo vetëm që bëhet e mundur me studime të mirëfillta duke marrë informatat kthyes nga industria apo institucionet publike, të cilat kanë një kërkesë për këtë lloj profilesh por dhe duke u bazuar në Misionin e Universitetit që përcakton fushat prioritare ku njësia akademike ushtron aktivitetin e saj.

Programi i studimeve Master i Shkencave në Gjeodezi (MScGJ) konsiderohet si një studim në vazhdimësi i studimit bachelor për gjeodezi i cili ofrohet në fakultetin tone apo edhe nga fakultetet e vendeve tjera.

Niveli i studimit bazohet në një sfond specifik të studimeve me të thelluar se sa në nivelin bachelor, ku studentet mund të përfitojnë njohuri me të theksuara shkencore të bazuar në hulumtim. Në këtë modul do të ketë një dedikim me të lartë për punën e ekipit hulumtues përmes projekteve të përbashkëta përmes grupeve të studenteve.

Moduli MScGJ në Gjeodezi ka synim për të transformuar pozitivisht shoqërinë duke dhënë një kontribut të rëndësishëm, duke influencuar politikën publike ku është përfshirë me ekspertizë

dhe punë të stafit e studentëve në një sërë reformash me impakt në përmbajtjen e kohës si dhe reforma e arsimit të lartë.

Ky program i studimeve është pjesë integrale e zbatimit të misionit që ka institucioni, dhe ka objektivat për edukimin e kuadrove, duke u mbështetur në arritjet më të fundit shkencore në fushat e gjeodezisë, gjeoinformacionit dhe vrojtimit të Tokës nga hapësira. Gjithashtu do të fokusohet edhe në aftësimin e studenteve me njohuritë e përgjithshme që lidhen me multi disiplinat dhe kompleksitetet e fushave inxhinierike, si problemet globale të specifikuar nga Agjenda 2030 e synimit të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG). Këtu theks i veçantë i dedikohet vëzhgimeve të Tokës nga hapësira, të dhënave gjeohapësinore dhe të dhënave tjera që lidhen me toke, ujë dhe ambientin. Këto burime u mundësojnë kombeve të analizojnë dhe modelojnë kushtet, të krijojnë harta dhe vizualizime të tjera, të vlerësojnë ndikimet nëpër sektorë dhe rajone, të monitorojnë ndryshimet me kalimin e kohës në një mënyrë të qëndrueshme dhe të standardizuar dhe të përmirësojnë llogaridhënien. Programi Master në gjeodezi do të bëjë disa ndryshime të cilat vijnë si rezultat i avancimeve sidomos në teknologjitë e vrojtimit të Tokës nga Hapësira. Këtu theks i veçantë do t'i kushtohet teknologjive të cilat ofrohen përmes programeve të ndryshme sidomos atij [COPERNICUS](#) i cili mundëson shfrytëzimin e sistemeve satelitore [SENTINEL](#) të cilët mundësojnë vrojtimin dhe monitorimin e ndryshimeve klimatike dhe ambientit në kohe reale.

Duke u bazuar në këto arritje teknologjike dhe me qëllim të përcjelljes së trendëve të tilla të cilët medoemos duhet të implementohen nëpër kurikulla, departamenti i gjeodezisë nga viti akademik 2021/2022 ka ndryshuar emrin dhe ai tani quhet “Departamenti i gjeodezisë, gjeoinformacionit, vrojtimit të Tokës nga hapësira”.

Duke u mbështetur edhe në objektivat, qëllimet dhe synimet e programit Kombëtar të Shkencës së Ekonomia evolutive dhe inovative të cilat dëshmojnë se zhvillimi i shoqërisë dhe ekonomisë varen, në masë të madhe, nga kapaciteti për të përfutur dhe për të prodhuar dituri të reja, të cilat mund të menaxhohen dhe të transformohen për të plotësuar nevojat kolektive dhe teknologjike të ekonomisë, të shoqërisë dhe të faktorëve social. Qasja tek njohuritë shkencore dhe teknologjike është konsideruar si një faktor i rëndësishëm i zhvillimit të vendit për tërheqjen e investimeve dhe përmirësimit të klimës së të bërit biznes.

Përveç tjerash, rifreskimi dhe zhvillimi i programit të studimeve për gjeodezi do të jetë i mbështetur nga kërkesat dhe nevojat e tregut të punës jo vetëm në nivel vendi mirëpo edhe jashtë tij, në nivel Evropë dhe më gjerë, prandaj edhe përditësimi i programit është i bazuar në shumë Institucione të Arsimit të Lartë në nivel rajonal dhe Evropian.

Pas pavarësisë, më 2008, Kosova përballet me problemin në fushën e çështjeve pronësore, kadastrale, inxhinierisë, ambientit: i gjithë gjeoinformacioni për harta dhe infrastrukturë bazike gjeodezike ka humbur për shkak të luftës së 1999-s. Vendi ka nevojë ta ndërtojë një dokumentacion të përditësuar në formë digjitale për të mundësuar një zhvillim ekonomik dhe një infrastrukturë të re në po këto dy fusha.

Me burime të ndryshme për financimin, një sistem kombëtar për kadastrën është në ndërtim e sipër. Ky sistem i ri kadastral ofron bazën teknike dhe ligjore për ta mbrojtur pronën private, për t'i lehtësuar transferet dhe vënien e taksave dhe për të promovuar investimin dhe

prodhimin. Reforma e tokave është e varur në një sistem kadastral, si edhe harta të sakta të lehta të qasshme dhe gjeoinformacione të tjera (të dhëna për kufijtë, zonat, pronësinë, vlerat, taksat etj.).

Megjithatë, edukimi në gjeodezi dhe kadastër në Kosovë, vetëm në kuadër të nivelit Bachelor, nuk mund t'i plotësojë nevojat dhe kërkesat e vendit. Si një vend i pavarur, Kosova, ka nevojë për një program të tillë, në mënyrë që të ofrohet një edukim i një niveli më të lartë në këtë fushë. Më 2003 një program Bachelor për gjeodezinë është hapur në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (UP), ndërsa programi Master ekziston që nga viti 2015 përmes programit TEMPUS.

Ky program synon të sigurojë studentët me aftësitë e duhura teknike dhe të menaxhimit të procesit të ndërtimit në mënyrë efektive për të kontribuar në këtë mjedis dhe të përgatisë studentët për karrierën e tyre si inxhinier por dhe si kërkues të ardhshëm.

Gjithashtu ky program synon të avancojë edhe përpilimin e një kutikulë e cila do të mundësojë departamentit të bashkëpunojë me universitetet tjera nga fusha e gjeoinformacionit dhe vrojtimeve nga hapësira.

Pas përfundimit të këtij niveli të studimeve studenti akumulon 120 ECTS dhe me titullin Master i Gjeodezisë (dhe Gjeoinformacionit).

2 VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT GJEODEZI (MScGJ)

2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi

Standardi 1.1. Misioni i programit të studimit MScGJ përputhet me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit të Ndërtimtarisë (FN). Programi, është i orientuar në mësimdhënie, mësimnxënie, kërkime të vazhdueshme shkencore, hulumtime dhe në ofrim të një programi të dizajnuar për të përmbushur tri qëllimet kryesore të programit (shih Standardin 1.3). Programi i studimit MScGJ ka një koncept të mirë-përcaktuar didaktik dhe kërkimor. Strategjia e Fakultetit të Ndërtimtarisë në vazhdimësi përcjell objektivat e inicuarra përmes Planit Strategjik të Universitetit të Prishtinës, duke mbështetur secilin program studimor në përmbushje të këtyre iniciativave [S2&S3]. Rritja e cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe hulumtim, synon në zhvillim të një programi të qëndrueshëm, dhe atë, duke: rishikuar në vazhdimësi programin e studimit MScGJ; avancuar me hulumtime shkencore (të mbështetura përmes granteve-programeve dhe projekteve ndërkombëtare, të mbështetura sado pak edhe përmes rritjes së financimit institucional dhe shpenzimeve hulumtuese me 1% të buxhetit vjetor të UP-ës (2020) [R4]; zhvilluar trajnime mbi përdorimin efektiv të platformës ScienceDirect, si mundësi e gjetjes së përmbajtjeve relevante në fusha të caktuara (2021)); bashkëpunuar me trupin këshilldhënës [T5] të formuar brenda FN-ës; krijuar laborator të duhur për fusha të caktuara në program; dhe duke rritur cilësinë e shërbimeve për studentë.

Standardi 1.2. Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve [K1], Programi MScGJ i takon nivelit të shtatë (7), i cili nivel përfshin programe akademike dhe profesionale, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me titullin Master. Studentët, titullin Master e sigurojnë përmes demonstrimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave për secilën lëndë në veçanti dhe gjithë programit në përgjithësi, brenda periudhës së studimeve. Roli i tyre kritik për të adresuar problemet specifike dhe zgjidhja nga ta e këtyre problemeve, arrihet përmes mësimdhënies. Duke përdorur metodologji të reja, duke siguruar zhvillim të stafit akademik me pjesëmarrje në trajnime të mësimdhënies, dhe trajnime për aplikime në projekte shkencore dhe profesionale, pjesëmarrje në konferenca, publikime kërkimore shkencore, përditësim të programeve studimore në përshtatje të kërkesave të tregut të punës, këshillime me trupin këshilldhënës [T5] për kërkesat e tregut, diskutime midis akterëve brenda FN-ës dhe bashkëpunime të FN-ës me palë jashtë saj (Institucione, kompani e organizata publike e private, vendore e ndërkombëtare), edhe programi MScGJ synon arrijen e rezultateve të mësimin në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Standardi 1.3. Programi ka për synim të arrijë këto tri qëllime kryesore: 1. Të edukojë gjenerata të master të gjeodezisë ashtu që të adresojnë sfidat që lidhen me gjeodezinë dhe gjeoinformatikën; 2. Të krijojë, zhvillojë dhe të përhapë njohuri të reja; 3. Të luaj rol udhëheqës në dhënie (ushqimin) e edukimit ndërdisciplinar, në mënyrë që të zgjidhen problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria. Në fakt, strategjia e FN-ës në lidhje me strukturën e studimeve dhe programin e studimit është që të ofrohet edukim i qartë duke krijuar kushte: për të qenë të hapur

ndaj ideve të reja, për kreativitet, për t'u angazhuar për mësim gjatë gjithë jetës dhe për të qenë të qëndrueshëm.

Mësimdhënia në Programin MScGJ në kontekst të përgjithshëm zhvillohet përmes ligjëratave, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, si dhe përmes bashkëpunimit të arsyeshëm mësimdhënës/student gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Programi MScGJ zhvillimin e lëndëve e ofron edhe përmes: vizitave studimore në teren të institucioneve të lidhura me gjeodezinë, kadastrin dhe të dhënat hapësinore në përgjithësi; organizimit të seminareve me karakter bazik hulumtues të cilat përgatiten në klasë duke shfrytëzuar laptop individual për marrje të informatave mbi metodologjitë, gjykimet, vendimet e rekomandimet nga rastet studimore të ofruara nga ueb-i. Po ashtu, ofrohen edhe informata të punimeve-hulumtimeve (si raste studimore) të zhvilluara e të publikuara në revista apo konferenca nga vet mësimdhënësi në kuadër të njësisë apo fushës së lëndës që ligjërohet. Është edhe vet trupi këshillëdhënës që ofron njohuri të punëve praktike me karakter profesional. Së fundi, në Dhjetor 2021, është mbajtur ligjëratë e hapur mbi “INSPIRE”. Në këtë kontekst, nga bashkëpunimi midis FN-ës dhe trupit këshillëdhënës, tani më në vazhdimësi organizohen ligjëratat të hapura (të vlerësuara fillimisht nga stafi i FN-ës si komision për vlerësimin e ligjëratës) në shërbim të stafit dhe studentëve. Programi i studimit MScGJ është i orientuar kah përmbushja e qëllimeve të përgjithshme të FN-ës, duke ofruar lëndë me përmbajtje moderne dhe të përditësuara, e që janë fleksibile dhe lehtë të adaptueshme me kërkesat lokale, rajonale dhe globale të tregut.

Standardi 1.4. Në Raportin e vlerësimit të programit, nga ekspertë ndërkombëtarë (Maj 2019, Raport i bashkëngjitur në këtë RVV) është rekomanduar: “Një listë me tituj dhe përshkrim të shkurtë të politikave, udhëzimeve dhe rregulloreve të përfshihet në RVV”. Një listë e tillë me tituj e përmbajtje të shkurtë si dhe vegza përkatëse për disa rregullore, njoftime dhe vendime ekzistuese që kanë të bëjnë me misionin, objektivat e administrimin e programit si dhe me çështjet e tjera të përfshira në RVV (menaxhim të cilësisë, staf akademik, proces mësimor, studentë, hulumtim dhe infrastrukturë) është ofruar në tabelën në vijim. Në tekstin e kësaj RVV-je, këto politika, udhëzime, rregullore e të tjera janë referuar nga po kjo tabelë (p.sh. për Statutin e UP-ës si: [S1]). Të tjera rregullore, udhëzime e politika që nuk janë të përfshira në këtë tabelë, por që kanë të bëjnë me çështje procedurale, akademike dhe të tjera janë të bashkëngjitura në “Listën e Referencave” në këtë RVV.

Tabela 1. Titujt dhe përshkrimi i shkurtë i rregulloreve/politikave dhe vegzat përkatëse

Statuti dhe Plane Strategjike			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
S1	Statuti i UP	Bazë statutore për rregullimin, funksionimin, financimin dhe sigurimin e cilësisë, përfshirë stafin dhe studentët në Universitetin e Prishtinës në përputhje me standardet evropiane.	https://uni-pr.edu/desk/inc/media/9E4445D9-FE24-47C5-9B1E-8059828B4D7E.pdf
S2	Plani strategjik i UP	Përmban iniciativa strategjike përfshirë periudhën kohore, akterët përgjegjës dhe koston e iniciativave për implementim.	https://uni-pr.edu/desk/inc/media/D7EAE629-A39D-4D4C-A598-93B7B5227EDB.pdf

S3	Strategjia e FN	Përfshin ambicidet, iniciativat e parapara nga Alumni, mbështetësit dhe bashkëpunëtorët tonë.	https://fn.uni-pr.edu/desk/inc/media/2194CD62-DE91-48D5-9EFA-70C9297A4D67.pdf
Korniza			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
K1	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve	Promovon ngritjen e cilësisë në arsim dhe aftësim. Synon që kualifikimet të jenë në harmoni me kërkesat për punësim, por edhe përmbushjen e kërkesave të ekonomisë dhe shoqërisë në vend.	Korniza kombetare e kualifikimeve - brendia.cdr (rks-gov.net)
K2	Korniza e Zonës Evropiane për Kualifikim të Arsimit të Lartë.	Elaboron kornizë të kualifikimeve, rekomandime dhe propozime për një kornizë gjithëpërfshirëse për kualifikime të arsimit të lartë.	Microsoft Word - PJE 180205 A Framework for Qualifications of the European ... (ecahe.eu)
Rregullore			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
R1	Rregullore për procedurat e pergaditjes së ri-akreditimit ne UP	Përcakton formën, proceset dhe procedurat për përgatitjen e akreditimit dhe riakreditimit institucional dhe të programeve studimore në UP.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregullore%5C53e6391d-e725-4849-a09e-6045788c0dcd31.3.2021.pdf&rrId=1170
R2	Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP	Vlerësim i stafit nga personeli akademik si komision vlerësues për aktivitetet: mësimore, hulumtuese, shkencore dhe shërbyese.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregullore%5C3243d708-7344-4e67-9f35-3f96b5e0b7f827.5.2021.pdf&rrId=3404
R3	Rregullore e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP	Përcakton procedurat vlerësuese për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm, përfshirë edhe të pensionuarit.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregullore%5Cebd6c945-dbf0-4ade-8b7d-89c6b64818ea25.6.2021.pdf&rrId=3419
R4	Rregullore për financimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore, artistike dhe sportive në UP	Përcakton mënyrat e financimit dhe ndarjes së mjeteve financiare për publikimeve shkencore e hulumtuese nga personeli akademik dhe studentët e PhD të UP-ës.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregullore%5C8217096-5fd4-434d-aa77-e1e8cdafb83b27.5.2021.pdf&rrId=3406
R5	Rregullore për studimet themelore – Master	Përcakton kriteret unike për studimet e nivelit Master.	https://studenti.uni-pr.edu/RregullorePublic/ShkarkoRregulloren?dok=Rregullore%5Ca17aef3b-1261-444c-bb1e-5417263be17615.3.2021.pdf
R6	Rregullore e punës së sistemit elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS) në UP	Përcakton standardet e përdorimit të SEMS.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregullore%5Cbe9d4ec5-55f9-4e61-b075-613c7195564312.5.2021.pdf&rrId=2390
R7	Rregullore për mobilitetet akademik të studentëve	Definon procedurat për mobilitet të studentëve.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregullore%5C6b0b3ede-996-42de-9806-d12a653632e226.3.2021.pdf&rrId=64

R8	Rregullore për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP	Përcakton procedurat disiplinore dhe masat e zbatueshme në rastet e përgjegjësive disiplinore të personelit akademik të UP-ës.	https://ekonomiku.uni-pr.edu/desk/inc/media/BAF4228A-69BC-4345-8BB7-F71FF34C26F3.pdf
R9	Rregullore për procedurën dhe masat disiplinore për studentët e UP	Përcakton procedura të përgjegjësive disiplinore, organet shqyrtuese të shkeljes disiplinore dhe masat e ndëshkimit disiplinore ndaj studentëve	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullor/en?dok=Rregullore%5C4e2a301d-9a21-4d98-85cc-598ecf42d18931.3.2021.pdf&rrId=145
R10	Rregullore për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e parlamentit studentor (PS) dhe këshillave të studentëve (KS) të UP	Përcakton procedurat për zgjedhje të PS dhe KS si dhe çështjet me të cilat mirren PS dhe KS.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullor/en?dok=Rregullore%5C8725a34b-aeaf-486b-9b3e-884ec66f22b131.3.2021.pdf&rrId=1162
R11	Rregullore mbi strukturën dhe parimet e punës të qendrës për përsosmëri në mësimdhënie në UP	Ndihmon në avansimin e kapaciteteve akademike dhe zhvillimin e sistemeve mësimore duke promovuar mësimdhënie efektive dhe cilësore të konkureshme në universitetet më të mira në Rajon dhe Botë.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullor/en?dok=Rregullore%5Cb4d8fe85-2619-44e5-85ef-79085c4db13129.3.2021.pdf&rrId=87
R12	Rregullore për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në UP	Rregullon çështjet e të ardhurave personale dhe kompensimit të punës për staf akademik në UP (të rregullt e të angazhuar) dhe ndër të tjera edhe krijimin e grupeve të studentëve.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullor/en?dok=Rregullore%5C86e0e3a8-8067-4b01-91fc-5166b1874eff24.10.2021.pdf&rrId=3455
Vendime			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
V1	Vendim mbi kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve themelore-bachelor	Përcakton kushtet të cilave u përmbahen studentët dhe administrata për lejmin e regjistrimit të vitit vijues të studimeve bachelor.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullor/en?dok=Rregullore%5C6daf4d42-bb6c-4355-81ba-d3e36db2cfa821.10.2021.pdf&rrId=3454
V2	Vendim për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit të diplomimit për studentët të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve në nivelin bachelor, master dhe doktoratë	Përcakton kushtet për vazhdim të kohëzgjatjes së afatit të diplomimit për studentë që kanë kaluar periudhën e lejuar të rregullt të studimeve.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullor/en?dok=Rregullore%5C80d1f99b-6c1f-41ce-a7ab-1c52d82412987.9.2021.pdf&rrId=3436
V3	Vendim i Senatit të UP-së, për zyrtarizimin e të gjitha udhëzimeve për zhvillimin e aktiviteteve akademike gjatë pandemisë COVID-19	Zyrtarizim të udhëzimeve për aktivitete akademike gjate pandemisë COVID-19 (ekzistojnë edhe njoftime për shërbimet e platformave virtuale ne pdf. format, të dorëzuar me e-mail nga Zyra e IT në Rektorat).	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullor/en?dok=Rregullore%5C15c8961b-7bdc-4fcc-b519-166fe39eb36e2.4.2021.pdf&rrId=2182
Udhëzime			

Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
U1	Udhëzim Administrativ nga MASHTI për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë	Proces i vlerësimit jashtë UP-së i zhvilluar nga AKA mbi akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë.	ilovepdf-merged.pdf (rks-gov.net)
U2	Udhëzues për shqyrtimin dhe rishikimin e Syllabusit	Mbështetje e stafit akademik/mësimdhënësit që t'i shkruajnë/shqyrtojnë/rishikojnë plan-programet e tyre në mënyrë adekuate që ta reflektojnë më mirë përmbajtjen e lëndës dhe metodologjitë e aplikuara.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5C4433d342-8016-4826-9374-e9a086f48d7b12.5.2021.pdf&rrId=2392
U3	Udhëzues për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimin e rezultateve të tyre	Vlerësime nga studentët për lëndët, mësimdhënësit dhe administratën. Shtyen në vetëpërmirësim të vazhdueshëm të mësimdhënësit në vecanti dhe programit studimor e FN-së në përgjithësi. Përfshin pyetësorin për mësimdhënës, lëndë, shërbim dhe infrastrukturë si dhe personel administrativ dhe personel mbështetës të UP.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5Ca55463ced0ce-4e7b-bfc6-3b3d4216192b29.3.2021.pdf&rrId=96
Tjera			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
T1	Sigurimi i cilësisë në UP	Vlerësime të stafit dhe mësimdhënies, të studentëve dhe mësimnxënies, të aktiviteteve hulumtuese dhe publikimeve në revista shkencore.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5C653eda16-1d3f-4111-bd6f-277ff6829bdc12.5.2021.pdf&rrId=2391
T2	Konkurs për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor për vitin akademik 2021-2022	Numri i studentëve dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore-baçelor.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5Ca53b53cb-b2e8-4b64-bc2a-9b6fe966c7a76.8.2021.pdf&rrId=3428
T2	Bashkëpunim ndërkombëtar	Marrëveshje Erasmus+ ICM (KA107).	https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1.61
T3	Marrëveshje bashkëpunimi në FN-a	Marrëveshje bashkëpunimi midis FN-ës dhe Institucioneve, kompanive e organizatave vendore dhe ndërkombëtare.	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1.56
T4	Kodi i Etikës i stafit akademik	Për të krijuar një ambient të favorshëm për shpërndarjen, zgjerimin dhe ekzaminimin kritik të njohurive si dhe për të çuar më tej kërkimin e së vërtetës dhe dijes.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5C18c680a7-7854-41fe-8533-3524dc70087a21.3.2021.pdf&rrId=51
T5	Trupi këshilldhënës (TK) i FN-ës	Themelimi i TK me anëtarë të tij.	Universiteti i Prishtinës (uni-pr.edu)
T6	Komuniteti Alumni	Rrjet i profesionisteve të FN-ës, si ambasadorë në rolin e tyre për implementimin dhe shpërndarjen e njohurive të cilat i kanë fituar gjatë studimeve BSc, MSc dhe PhD.	Universiteti i Prishtinës (uni-pr.edu)

T7	Këshilli studentor	Përfaqësues të këshillit të studentëve nga FN	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1.23
T8	Qendra për Zhvillim të Karrierës	Ndihmon studentët dhe të diplomuarit për zhvillim të njohurive dhe shkathtësive që do t'i ndihmojnë gjatë punësimit, si dhe ofrojnë informata për maturantët rreth studimeve në UP.	https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1.78
T9	e-Karriera	Platformë njoftuese për aktivitete të ndryshme në shërbim të studentëve (në nivel të FN-ës dhe nivel të UP-ës).	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1.41 https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1.84
T10	Infrastruktura për kërkime shkencore në UP	Përbërja e laboratoreve në njësitë akademike të UP-ës.	https://www.uni-pr.edu/desk/inc/media/041DEACC-F20C-41F2-801E-B19DAE1F431C.pdf

Standardi 1.5. I gjithë stafi dhe studentët e programit të studimit MScGJ janë në përputhje me rregulloret e brendshme që kanë të bëjnë me sjelljen etike [T4] në mësimdhënie, hulumtim dhe vlerësim në të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative.

Standardi 1.6. Për t'i bërë të qëndrueshëm programin, të gjithë akterët brenda FN-ës: Menaxhmenti i FN-ës, koordinatori për zhvillim akademik në FN, koordinatori me anëtarë të programit, mësimdhënësit, studentët, komuniteti i trupit këshilldhënës [T5], këshilli i fakultetit dhe komisioni i studimeve i FN-së që në përbërje kanë staf të FN-ës dhe përfaqësues të studentëve si dhe komuniteti alumni i FN-ës [T6], kontribuojnë në rishikim, vlerësim dhe përmirësim të programit. Si i tillë, programi përcillet për vlerësim në strukturat dhe mekanizmat relevant të UP-ës, dhe atë: prorektori për cilësi, zyra për zhvillime akademike (ZZHA), komisioni për cilësi, dhe në fund tek Agjencioni i Kosovës për Akreditim (AKA). Kjo e fundit ofron rekomandime përmes ekspertëve të jashtëm, me të cilat programi plotësohet, përmirësohet dhe zhvillohet deri në rishikimin e radhës. Rugëtimi i rishikimit të programit MScGJ definohet me: Dispozita staturore, Rregullore për procedura të përgatitjes së riakreditimit, Udhëzues për shqyrtim dhe rishikim të syllabuseve [S1; R1; U2].

Zhvillimi i qëndrueshëm i programit synohet: me përforcimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve midis fakultetit, komunitetit të trupit këshilldhënës dhe komunitetit alumni (duke ofruar informata të ndërsjella për kërkesat e tregut të punës dhe përditësimin të kurrikulës) [T5&T6]; me rritjen e cilësisë së stafit akademik në mësimdhënie (përmes trajnimeve të ofruara nga UP-ja dhe publikimeve të rezultuara qoftë përmes projekteve hulumtuese e shkencore (duke aplikuar në projekte ndërkombëtare me grante, apo nga studimet PhD të stafit); si dhe me rezultatet e mësimnxënies (kalueshmëria e studentëve e prezantuar në raport statistikor nga sistemi elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS)). Sigurisht, FN-ja në të gjithë këtë proces nuk anashkalon edhe personelin administrativ në shërbim të stafit dhe studentëve dhe zhvillimin e infrastrukturës, si bazë për program të qëndrueshëm.

Analiza SWOT-it për misionin, objektivat dhe administratën:

A. Pikat e forta

- Mision i qartë dhe në përputhje me misionin e FN-së.
- Objektivat programit përkrahin misionin e fakultetit dhe bazohen në nevojat e përmendura në program.
- Është në harmoni me nevojat aktuale të Agjendën 2030 të SDG dhe INSPIRE.

- Zhvillimi e kapaciteteve njerëzore, që do të kontribuojnë në përmirësim të fushës së gjeodezisë dhe gjeoinformacionit.
- Punë praktike në laboratorët të pajisur me teknologjitë e kohës.

B. Dobësitë

- Arritja e objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies edhe me aktivitete, që plotësojnë nevojat e jetës sociale dhe kulturore.

C. Mundësitë

- Zhvillimi i programeve të përbashkëta me departamentet tjera, brenda apo jashtë fakultetit.
- Konkurrimi në projekte të ndryshme me fonde nacionale apo internacionale në funksion të përmirësimit të cilësisë akademike dhe hulumtimeve shkencore.

D. Sfidat

- Krijimi, sigurimi i fondeve për infrastrukturë dhe ngritjen kapacitetesh teknologjike.
- Hapja e vendeve të reja të punës për mësimdhënës, asistentë dhe/ose shërbime administrative.
- Për arsye të pandemisë mund të ketë vonesa në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në hulumtime të përbashkëta dhe shkëmbim akademik.

2.2. Menaxhimi i cilësisë

Standardi 2.1. Fakulteti i Ndërtimtarisë (FN) me një përvojë qysh nga themelimi (1961), në vazhdimësi synon të ruaj qëndrueshmërinë përmes sigurimit të cilësisë në favor të komunitetit brenda dhe jashtë vendit (studentëve, stafit, shoqërisë). Sigurimi i cilësisë në FN-a mbështetet në instrumentet për sigurim të cilësisë të UP-ës [T1]. Në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit zhvillohen: Vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm. Mekanizmat dhe instrumentet bazë të sigurimit të cilësisë në nivel institucional janë: komisioni për sigurim të cilësisë, komisioni i studimeve, zyra për zhvillim akademik në nivel Universiteti. Në përmirësim dhe adaptim të kurrikulës së programit MScGJ në nivel të FN-ës kontribuon grupi punues për rishikim të programit të studimit, dhe atë: menaxhmenti i njësisë akademike (FN-ës), koordinatori për zhvillim akademik, koordinatori me bartësit dhe anëtarë të programit përkatës, komuniteti alumni, mësimdhënësit, studentët aktual dhe ish studentët. Po ashtu shtytje e ngritjes së cilësisë në programin MScGJ është edhe bashkëpunimi me trupin këshillëdhënës [T5] që funksionon në kuadër të FN-ës e që përmban përfaqësues të institucioneve, kompanive e organizatave publike e private si dhe përfaqësues të stafit të fakultetit. Përfaqësuesit e trupit këshillëdhënës, në fakt janë komunitet i FN-së, që u mundëson mësimdhënësve ngritjen e cilësisë së kurrikulës në kontekst të nevojave të tregut të punës në njërin anë dhe në anën tjetër kontribuon në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e programit bazuar në kërkesat e tregut. Ndërsa, vlerësimin nga jashtë, nëse programi ka plotësuar apo jo standardet ndërkombëtarisht të pranuar të cilësisë, i zhvillon Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) e themeluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Hapat e organizimit dhe procesit të vlerësimit për riakreditim të programit shihen edhe në diagramin e pasqyruar në Rregulloren për procedurat e përgatitjes së riakreditimit [R1].

Standardi 2.2. Procesi i vlerësimit dhe planifikimi për përmirësim vazhdimisht merren parasysh dhe integrohen në planifikim të programit. Gjetjet si të arritura, shtyhen më tutje, ndërsa

mangësitë përmirësohen dhe si të tilla përfshihen për t'u implementuar në program. Programi MScGJ duke konsideruar në vazhdimësi këto procese, ka arritur që në vazhdimësi të vlerësohet dhe të akreditohet nga ekspertë ndërkombëtarë dhe vendor (të përzgjedhur nga AKA). Në kuadër të kësaj, në tabelën në vijim janë prezantuar periudhat e akreditimit dhe riakreditimit të programit MScGJ, për të cilat edhe ekzistojnë raportet dhe vendimet zyrtare, në faqe të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), gjegjësisht në vegzën: <https://akreditimi.rks.gov.net/wp-content/uploads/2020/10/2021-3020-Vendim-Fakulteti-i-Ndertimtaris-Prishtine.pdf>.

Tabela 2. Periudhat e akreditimit/riakreditimit të programit MScGJ

Njësia Akademike	Departamenti	Programi i studimit	Nivel i studimit	Akreditim	Vazhdim Akreditimi	Riakreditim
FN	Gjeodezi	MSc Gjeodezi	Master	2015-2018	2018-2019	2019-2022

Standardi 2.3. Fakulteti i Ndërtimtarisë (FN) në bashkëpunim me mësime të organizojnë mësime të provimit dhe vlerësimit të studentëve. Vetëvlerësimi i stafit akademik (arritjeve shkencore dhe profesionale) dhe i lëndës mësimore; vlerësimi i performancës së stafit akademik; monitorimi i mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe implementimit të kurrikulës (ligjërata, ushtrime, provime) nga menaxhmenti dhe nga diskutimet midis shefit të departamentit dhe studentëve shtojnë në vazhdimësi ngritjen e cilësisë në FN-a. Së fundi, (në Nëntor, 2021) në UP është mbajtur një punëtori dy ditore midis menaxhmentit të UP-ës dhe HERAS+ (ekspertë ndërkombëtarë) për mundësinë e përpilimit dhe implementimit të udhërrëfyesit për matjen e performancës së stafit akademik të UP-ës, duke përfshirë kartelën vlerësuese të performancës në katër fusha kryesore me rëndësi për UP-ën: mësime, hulumtim, zhvillim institucional dhe shërbim të komunitetit (shih vegzën: <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,37,1510>). Edhe vlerësimi i personelit administrativ që shërbejnë stafin dhe studentët edhe i burimeve financiare e edhe infrastruktura janë tregues të zhvillimit të cilësisë në FN-a. Të gjitha këto procese përfshihen në planifikim dhe implementim të programit studimor e që mbështeten nga niveli qendror i UP-ës, në përputhje me rregulloret që kanë të bëjnë me sigurim të cilësisë në Universitetin e Prishtinës.

Standardi 2.4. Një pasqyrë e çështjeve të cilësisë për programin në veçanti dhe fakultetin në përgjithësi në lidhje me rezultatet e mësimeve dhe mësimeve, si mënyra të vlerësimit të dijes, ofrohet duke aplikuar: provime, kolokfiume, punime seminarike, përfshirë edhe interpretimin dhe prezentimin e tyre, praktika profesionale si dhe teste praktike gjatë ushtrimeve. Këto vegla shfrytëzohen me qëllim që të vlerësohet se sa secili student ka arritur rezultatet e pritshme të nxënies në secilën lëndë. Vlerësimi përfundimtar i studentëve publikohet në faqen “Fletëparaqitjet” në SEMS, në të cilën faqe, secili mësime ka çasje përmes llogarisë së veçantë. Standardet e përdorimit të SEMS-it janë të përcaktuara në rregullore të veçantë [R6]. Në nivel shumë bazik, vlerësimi i studentit në lëndën individuale referon nivelin e bartjes së suksesshme të njohurive të dëshiruara. Në nivel më të përgjithshëm, matjet, si p.sh. përqindja e pjesëmarrjes dhe përqindja e kalueshmërisë së studentëve në provime, po ashtu reflektojnë nivelin e arritjes së objektivave të programit. Arritja e objektivave për lëndë në veçanti vlerësohet përmes raportit statistikor i cili nxirret po ashtu nga

faqja “Fletëparaqitjet” në SEMS. Raporti statistikor i kalueshmërisë së studentëve, i përmbledhur për një vit për të gjitha programet e FN-ës ofrohet tek mësimdhënësit nga menaxhmenti i FN-ës. Menaxhmenti i FN-ës kumton arritjet dhe mangësitë në implementim të programit dhe po ashtu me grupin punues reflektojnë dhe sugjerojnë aktivitete për planifikim të ngritjes së cilësisë në nivel fakulteti.

Standardi 2.5. Duke marrë parasysh në vazhdimësi proceset vlerësuese të sipërpërmendura në lidhje me vlerësim dhe përmirësim të cilësisë në program, sigurohet se standardet e kërkuara janë përmbushur.

Standardi 2.6. Të dhënat e ofruara nga anketa për vlerësim nga studentët për lëndët, mësimdhënësit dhe administratën e që gjendet në Udhëzues për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimin e rezultateve të tyre [U3], shtynë në vetë përmirësim të vazhdueshëm të mësimdhënësit në veçanti dhe programit studimor, si dhe FN-ës në përgjithësi. Edhe komentet e studentëve, dhe ish studentëve konsiderohen instrument me rëndësi në performancën e programit. Të dhënat mbi arritjet e mësimdhënësve janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të FN-ës (shih Faqen Personeli Akademik në vegzën: [Universiteti i Prishtinës \(uni-pr.edu\)](http://uni-pr.edu)). Po ashtu, një tregues i cilësisë është edhe numri i të diplomuarve në kohë e që ky numër gjenerohet nga administrata e FN-ës si (shih në shtojcë të kësaj RVV-je tabelën mbi Studentët: “Numri i studentëve dhe të diplomuarve në tre vitet e fundit”). Në nivel të UP-ës dhe në nivel të vet FN-ës është themeluar edhe komuniteti Alumni [T6] si ambasador kyç në rolin e tyre për implementimin dhe shpërndarjen e njohurive që i kanë fituar gjatë studimeve baçelor, master apo doktoratë.

Standardi 2.7. Rezultatet e të gjitha proceseve vlerësuese që përbëjnë sistemin e brendshëm për sigurim të cilësisë në lidhje me studentët merren parasysh për të siguruar cilësi të qëndrueshme. Këto rezultate për lëndë në veçanti marrin parasysh: vijueshmërinë e studentëve, vlerësimin e studentëve me test, kollokfiumin, punën laboratorike, punën në teren, detyrat e shtëpisë dhe provimin final. Ndërsa, për rezultatet e arritjeve të aftësive profesionale të fituara gjatë studimeve, studentët vlerësohen përmes punimit të diplomës. Në programin MScGJ shpesh herë aplikohet integrimi i zhvillimit të punës praktike nga studenti gjatë studimeve (si lëndë e veçantë në kurrikulën e programit) në temën e diplomës.

Standardi 2.8. Përmirësimi i vazhdueshëm në nivel programi (çdo 3/5 vjet) ndodh duke u bazuar edhe në rekomandime të ekspertëve të jashtëm për vlerësim të programit. Ekspertët e jashtëm përzgjedhen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) e cila përcakton ndër të tjera edhe standardet për sigurim të cilësisë në përputhje me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare për cilësi në arsimin e lartë. I tërë sistemi për sigurimin e jashtëm të cilësisë është i rregulluar me Udhëzim Administrativ të lëshuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të lartë në Republikën e Kosovës [U2]. Raporti i vlerësimit mbi cilësinë e përgjithshme të programit përgatitet në

mënyrë periodike për shqyrtim brenda FN-ës duke paraqitur edhe arritjet e edhe mangësitë e programit.

Standardi 2.9. Cilësia e programit përmirësohet vazhdimisht:

- pas marrjes në konsideratë të të gjitha vlerësimeve për procese të veçanta të sistemit të cilësisë, përfshirë rekomandimet nga ekspertët e jashtëm të zgjedhur nga AKA,
- pas aplikimit të të gjitha rregulloreve dhe udhëzimeve që ndërlidhen me sigurimin e cilësisë në nivel të UP-ës për vetë-vlerësim,
- pas aplikimit të të gjitha rregulloreve dhe udhëzimeve që ndërlidhen me sigurimin e cilësisë në nivel të MASHTI-it për vlerësim të jashtëm.

Në mënyrë periodike (për kohë validiteti të programit të akredituar), FN-ja përgatit raporte vetëvlerësimi duke marrë parasysh të gjitha proceset, instrumentet dhe mekanizmat me ndikim në performancë dhe implementim sa më të qëndrueshëm të secilit program në kuadër të FN-ës.

Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:

A. Pikat e forta:

- Menaxhimi dhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes raportimeve dhe vlerësimeve periodike.
- Monitorimi i cilësisë dhe i sigurisë së shërbimeve përmes raportimeve dhe komunikimit me studentë.
- Transparenca e arritshmerisë në nivel të njësisë akademike përmes sistemit digjital.
- Komunikimi i ngushtë me trupin këshillëdhënës dhe alumnistët, si komunitete të FN-ës.

B. Dobësitë:

- Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm në nivel ndërkombëtar duke marrë parasysh disa faktore.
- Mungesa buxhetore për trajnime dhe përmirësime në monitorimin e cilësisë.

C. Mundësitë:

- Rritja e kontrollit/monitorimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, prezencës në mësim/ligjërata/ushtrime të studentëve përmes SEMS-it.
- Ngritja e kapaciteteve administrative dhe trajnimi i tyre për praktika ndërkombëtare të punëve administrative dhe të monitorimit të cilësisë.
- Mundësia e qëndrueshmërisë së cilësisë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.

D. Sfidat:

- Plotësimi i vendeve të reja të punës për mësimdhënës, asistentë dhe/ose shërbim administrativ që ndihmon në kërkesën për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore.
- Shkurtime buxhetore eventuale për personelin e ri mund të ndikojnë menaxhimin e cilësisë.
- Përgjegjshmëria e universiteteve private, fitimprurëse dhe on-line ndaj kërkesave të programeve dhe programeve të studentëve.
- Rritja e raportimit që pritët nga qeveria dhe shoqëria.
- Ndryshimi i fokusit në arritjet numerike kundrejt arritjeve cilësore.

2.3. Staf akademik

Standardi 3.1. Staf akademik i punësuar në programin MScGJ, respektivisht në FN realizon aktivitetin e tij në përputhje të plotë me dispozitat statutare të UP-ës. Në programin MScGJ janë të përfshirë: staf akademik në marrëdhënie të rregullt pune (nga UP), si staf akademik i rregullt; dhe staf akademik në marrëdhënie të angazhuar (nga jashtë UP-ja), si staf akademik i anagazhuar. Në tabelën në vijim është dhënë profili i mësimitdhënësve (të cilët zhvillojnë ligjëratat) të përfshirë në programin studimor MScGJ. Tabela pasqyron mësimitdhënësit, njësitë akademike që përfaqësojnë këta mësimitdhënës (brenda UP-ës), gradën shkencore dhe thirrjen akademike, orët e mësimitdhënies bashkë me ECTS-ët e lëndëve për të cilat këta mësimitdhënës janë përgjegjës si dhe hulumtimet si aktiviteti i mësimitdhënësve, e që janë të prezentuara në CV të secilit mësimitdhënës (shih në shtojcë të kësaj RVV-je - CV e stafit akademik, apo në vegzën: <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,14>, CV për secilin mësimitdhënës.

Tabela 3. Profilet e mësimitdhënësve të përfshirë në programin MSc Gjeodezi

Nr.	Mësimitdhënësi	Njësia Akademike Fakulteti - Universiteti	Grada shkencore	Thirrja akademike	Kontrata ²	ECTS	Orë mësimit		Hulumtimet ³
	Emri dhe Mbiemri						O	Z	
Stafi Akademik, i rregullt									
1	Abdullah Zejnullahu	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Dr.	KRr	6	2		CV
2	Bashkim Idrizi	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Ass. Dr.	KRr	30	6	4	CV
3	Fidan Salihu	FN-UP	Dr. Sc.	Ass. Dr.	KRr	3	2		CV
4	Murat Meha	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Dr.	KRr	12	4	2	CV
5	Përparim Ameti	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Asoc. Dr.	KRr	24	6	4	CV
6	Ymer Kuka	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Ass. Dr.	KRr	15	9	6	CV
7	Fitore Bajrami Lubishtani)*	FN-UP	MSc	asistent	KRr	24	4	4	CV
8	Besim Ajvazi)*	FN-UP	MSc	asistent	KRr	12	4		CV
Stafi Akademik, i angazhuar									
1	Ismajl Kabashi	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Ass. Dr.	KP	12	4		CV
2	Ardita Ibishi	FN-UP	MSc.	Lektore	KP	3	2		CV
3	Milaim Sylka)*	FN-UP	MSc	asistent	KP	18	6		CV
4	Fisnik Loshaj)*	FN-UP	MSc	asistent	KP	12	2	2	CV
5	Dafina Tmava	FN-UP	MSc	asistent	KP	24	4	4	CV

Shkurtesat nga tabela e më sipërme:

FN - Fakulteti i Ndërtimtarisë; FA - Fakulteti i Arkitekturës; FSHMN - Fakulteti i Shkencave Matematike, Natyrore; FIM - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; FM - Fakulteti i Mjekësisë; FGJS - Fakulteti i Gjeoshkencave; UP - Universiteti i Prishtinës; UM - Universiteti i Mitrovicës

KRr – Kontratë e rregullt; KP – Kontratë e pjeshme; PV – Profesor visitor

CV – biografia e secilit nga stafi akademik (për hulumtime shih CV-në, për secilin mësimitdhënës në vegzën:

<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,14>)

)*Kandidat PhD

Standardi 3.2. Për stafin akademik pjesëmarrës në programin MScGJ, Universiteti i Prishtinës lëshon: kontratë të rregullt (KRr) për staf akademik në marrëdhënie të rregullt pune dhe kontratë të pjeshme (KP) (varësisht nga nevoja e fakultetit, e cila ka kohëzgjatje 1 vjeçare)

për staf akademik në marrëdhënie pune të angazhuar. I gjithë stafi pavarësisht llojit të kontratës, plotëson kriteret ligjore për pozitat përkatëse dhe është në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë nga MASHTI, Neni 26, pika 5.3 [U1].

Standardi 3.3. Programi i studimit MScGJ numëron staf akademik me kontratë të rregullt të cilët punojnë vetëm në një institucion të arsimit të lartë. D.m.th. FN-ja në programin MScGJ ka të angazhuar staf akademik të përzgjedhur në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të vitit 2018, Neni 26, pika 5.3.14 dhe 5.3.15 [U1].

Standardi 3.4. Programi i studimit MScGJ numëron gjithsej trembëdhjetë mësimitdhënës (8 profesorë dhe 5 asistentë). Sipas titujve akademik, programi numëron dy Profesorë të rregullt (Dr. Sc. Prof.); një Profesorë të asocuar (Dr. Sc. Prof. Asoc.); Tre Profesorë asistentë (Dr. Sc. Prof. Ass.); një Lektor; dhe gjashtë Asistentë (Ass.). Një asistent është me titull Dr, ndërsa pesë të tjerë janë në përfundim të studimeve të doktoratës. Shiqar nga numri i ECTS-ve në program (Tabela në Standardin 3.1), gjegjësisht nga pesha e ECTS-ve të ndara për lëndë të profesorëve, i bie që: nga numri i përgjithshëm i ECTS të ndara për lëndë obligative, 60 ECTS janë të mbuluara me mësimitdhënës (profesorë) me kontratë të rregullt nga UP-ja dhe vetëm 6 ECTS mbulohen nga profesorë me kontratë të pjesshme (1 vjeçare). Për nga numri i përgjithshëm i orëve, të ndara për lëndë obligative, për mësimitdhënës, 20 orë mbulohen nga profesorë me kontratë të rregullt nga UP-ja, 4 orë mbulohen nga mësimitdhënës të angazhuar nga jashtë UP-ja. Nga numri i përgjithshëm i mësimitdhënësve si profesorë, në marrëdhënie të rregullt pune, me kontratë nga UP-ja, janë të përfshirë 87%. Kjo nënkupton se raporti i mësimitdhënësve me kontratë të rregullt dhe me kontratë të pjesshme ka ndryshuar në favor të mësimitdhënësve me kontratë të rregullt, gjë që është rekomanduar edhe nga ekspertë ndërkombëtarë në vlerësim të RVV të vitit 2019.

Standardi 3.5. Fakulteti i Ndërtimtarisë, në kuadër të të cilit implementohet programi studimor MScGJ, ka të siguruar staf të mjaftueshëm me normë të plotë dhe me titull akademik Dr. Rekrutimi i stafit të ri akademik zhvillohet në bazë të kërkesave të fakultetit dhe sigurisht në kohën kur UP shpall konkurs për staf të ri akademik.

Standardi 3.6. Programi i studimit MScGJ përkrahet nga mësimitdhënës, të cilët fushë interesi kanë çështjet që lidhen me gjeodezinë dhe gjeoinformatikën. Programi përfshin mësimitdhënës të cilët janë të trajnuar për metoda mësimitdhënie si dhe për praktika të vlerësimit të studentëve në kontekst të mësimitdhënies. Trajnimet e stafit akademik janë zhvilluar në baza individuale për certifikim. P.sh. trajnimet të organizuara nga Qendra për Përsosmëri në Mësimitdhënie e UP-ës [R11], dhe atë: trajnime të nivelit bazik “Mësimitdhënia në arsimin e lartë”, dhe trajnime të nivelit të avancuar “Planifikimi dhe implementimi i mësimitdhënies në arsimin e lartë”. Ftesa në këto trajnime bëhet për gjithë stafin akademik me të drejtë aplikimi stafi në marrëdhënie të rregullt pune nga UP-ja. Në fakt, avancimi i stafit akademik kërkon edhe përmbushjen e kriterit të trajnimeve në mësimitdhënie (shih “Formularët e Komisionit Vlerësues për Emërimin e Personelit Akademik, për Marrëdhënie Pune në Institucionin Arsimor të Lartë”) [R2]. Po ashtu, stafi inkurajohet të marrë pjesë në projekte shkencore, të konkurojë për bursa të mobiliteteve akademike të mësimitdhënësve me universitete jashtë vendit. Shfrytëzimi i fondeve Erasmus+

për bashkëpunim ndërkombëtar në kuadër të të cilave organizohen jo vetëm ligjërata, por edhe konferenca, workshope e trajnime që lidhen me qëllimin e projekteve ofrojnë përfitime përvojash dhe modele të praktikave të mira me ndikim në ngritjen profesionale dhe akademike.

Standardi 3.7. Sipas dispozitave të kontratës së punës dhe në përputhje me politikat e FN-ës, stafi akademik, gjegjësisht mësimdhënësi është në disponueshmëri për kohë të mjaftueshme për t'ju ofruar studentëve këshilla atëherë kur ata kanë nevojë në lidhje me lëndën e caktuar. Mësimdhënësi u ofron studentëve tekstin, literaturën bazë mësimore, udhëzime për punime seminarike, si dhe për format e tjera të shfrytëzuara për mësimdhënie dhe mësimnxënie në kuadër të lëndës të cilën e zhvillon. Literaturë tjetër, ofrohet si literaturë shtesë nga mësimdhënësi për studentët të cilët shprehin interesim për studim më të hollësishëm gjatë studimeve në fushën me interes, apo për mësim gjatë gjithë jetës (life-long learning). Secili mësimdhënësi është në disponueshmëri të vazhdueshme për të ofruar konsulencë dhe ekspertizë që lidhen me fushat e interesit të mësimdhënësit për nevoja të komunitetit.

Standardi 3.8. Stafi akademik i programit MScGJ sikur edhe i tërë stafi i FN-ës i nënshtrohet vetëvlerësimit dhe pyetësorëve nga ana e personelit akademik, (ashtu siç kërkohet të definohet edhe në Formularët e Komisionit Vlerësues për Emërimin e Personelit Akademik, për marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor të Lartë) [R2], përfshirë vlerësimin e stafit për aktivitete arsimore (mësimdhënie, organizim të vizitave studimore, ftesë të ligjëruesve vizitor, literaturë dhe mekanizma për vlerësim të mirëfillt të studentëve), për aktivitete hulumtuese, shkencore dhe profesionale (publikime në revista shkencore me recension ndërkombëtar, pjesëmarrje në konferenca shkencore, pjesëmarrje në projekte hulumtuese, shkencore dhe profesionale, recensione në revista akademike dhe profesionale) si dhe për aktivitete shërbyese për UP-ën, FN-ën dhe për komunitetin (detyra të caktuara nga niveli i UP-ës, FN-ës, apo në baza vullnetare).

Me qëllim të kontrollit të aktiviteteve akademike të zhvilluara nga stafi akademik shfrytëzohen edhe pyetësor anonim të formuluar nga rektorati, të plotësuar nga studentët. Përmes këtyre pyetësorëve vlerësohet edhe stafi akademik, e edhe lënda. Po ashtu vlerësohen edhe shërbimi dhe infrastruktura dhe personeli administrativ dhe mbështetës i UP-ës [U3]. Në këta pyetësor studentët ka mundësi të jap vlerësimin e tij për çdo lëndë në veçanti, përfshirë edhe vlerësimin për mësimdhënësin e lëndës. Pasqyrë e performancës së stafit akademik është edhe monitorimi i mbarëvajtjes së procesit mësimor (ligjërata, ushtrime, provime) dhe rezultateve të mësimnxënies (duke krahasuar me syllabusin e lëndës) që zhvillohet nga menaxhmenti i FN-ës dhe shefi i departamentit. Mbarëvajtja e mësimin, kalueshmëria e edhe pjesëmarrja e studentëve në mësim kontrollohen edhe përmes SEMS-it.

Standardi 3.9. Me vlerësim të rregullt të stafit akademik, siç është elaboruar edhe në standardet 2.3 dhe 2.6 dhe 3.8 arrihet edhe sigurimi i cilësisë së programit. Ofrimi i materialeve të duhura mësimore, si literaturë bazë dhe literaturë shtesë për fitim të njohurive për studentët e po ashtu përditësimi edhe i përmbajtjes së lëndës shtyn në sigurim të cilësisë të programit MScGJ. Një strategji tjetër e sigurimit të cilësisë nëpërmjet mësimdhënies dhe materialit mësimor është shfrytëzimi i mobiliteteve nga ana e stafit akademik i FN-ës, përmes programeve të EU programme “Erasmus+”, apo WUS Austria “Course Development Program plus (CDP+)” duke kontribuar në reformim të mësimdhënies (mësimdhënie, kurrikulë e literaturë).

Standardi 3.10. Marrëdhënia e punës së mësimdhënësit si: staf i rregullt, staf i angazhuar si dhe staf i pensionuar rregullohet me: Statut të UP-ës, konkretisht Neni 169 dhe 170 mbi Punonjësit e Universitetit – Stafit akademik dhe jo akademik [S1]; Rregullore për procedurat për zgjedhëse të personelit akademik në UP [R2] dhe Rregullore për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP [R3]. Staf i rregullt sipas dispozitave të UP-ës llogaritet të jetë mësimdhënësi i cili nuk ka ndonjë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet tjetër [R3]. Mësimdhënësit e pensionuar konsiderohen mbi moshën 65 vjet, por që në mësimdhënie angazhohen si staf me kontratë me kohë të pjesshme dhe ate deri në moshën e lejuar me akte të veçanta. Për këtë kategori të mësimdhënësve, vendimin për angazhim për vitin akademik përkatës e nxjerr këshilli i fakultetit [R2].

Analiza SWOT për stafin akademik:

A. Pikat e forta:

- Mësimdhënës të kualifikuar.
- Mësimdhënës me eksperience në hulumtime ndërkombëtare.
- Mësimdhënës të trajnuar për metoda mësimdhënie si dhe për praktika të vlerësimit të studentëve në kontekst të mësimnxënies.
- Staf me njohuri te mira ne përdorimin e teknologjive te reja dhe gjuhëve te huaja.

B. Dobësitë

- Mungesat buxhetore për ngritjen e stafit sidomos në hulumtime shkencore.

C. Mundësitë

- Zhvillimi i mëturjesheëm profesional e shkencor përmes bashkëpunimit me industrinë.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar përmes programeve të Bashkësisë Europiane (BE) dhe atyre jashtë BE.
- Rritja e performancës në fusha specifike sipas kërkesës së tregut të brendshëm dhe të jashtëm.

D. Sfidat

- Sigurimi i mbështetjes institucionale – financiare për ngritjen akademike dhe aktivitetin kërkimor të stafit mësimdhënës.

2.4. Përmbajtja e procesit arsimor

Standardi 4.1 Programi MScGJ aftëson studentë për karrierë profesionale (në zyra dizajni, inxhinierike, konsulence, në industri, në shoqatë, në sektor te ndryshëm publik etj.) në bashkëpunim me të tjerët për të siguruar ndryshim dhe zhvillim të ideve të reja. Po ashtu, programi MScGJ aftëson studentë edhe për studime të mëtejme në fushën e gjeodezisë dhe gjeoinformatikës.

Në objektivin e Programit te Studimit MSc Gjeodezi është definuar qasja ashtu që të garantojë formim të avancuar dhe kompetenca të specializuara përmes dhënies së njohurive teorike dhe praktike më të thelluara në fushën e Gjeodezisë, si dhe të aftësojë studentët për kryerjen e kërkimit të pavarur shkencor përmes dhënies së njohurive, metodave dhe teknikave të kërkimit shkencor.

Organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies përbën procesin që ndiqet, monitorohet e kontrollohet me shumë kujdes si për mbarëvajtjen ashtu dhe në aspektin cilësor. Metodrat dhe Teknikat e mësimdhënies që aplikohen janë të shumëllojshme. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies një drejtimore (nga pedagogu tek studenti), këto metoda tentojnë drejt formave të mësimin me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e ligjëruesit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve.

Standardi 4.2. Programi i studimit MScGJ është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve [K1] dhe Kornizën e Zonës Evropiane për Kualifikim të Arsimit të Lartë [K2]. D.m.th. Programi MScGJ i takon nivelit të shtatë (7) të kualifikimeve me dy vite studimi me orar të plotë. Ky program ofron bazë për përparim të mëtejshëm në studime të arsimit të lartë. Versioni aktual i programit është krijuar nëpërmjet projektit, financuar nga TEMPUS (përfunduar, më 2016) nën drejtimin e KTH Stockholm si edhe me universitetet partnerë si: University of West Hungary, Aristhoteli University of Thessaloniki, Vilnius Technical University. Pra, një version përfundimtar i strukturës së moduleve të programeve Master është projektuar me përfshirjen e 4 partnerëve të EU Tempus. Shkenca e gjeoinformacionit si pjesë e rëndësishme e programit, do të ndihmojë shumë në aftësimin e studentëve në lidhje me aplikimin e njohurive të tyre në sektorë të ndryshëm, të cilën bazë kanë menaxhimin e informacioneve me përmbajtje hapësinore. Si të tillë, ekspertët e jashtëm për vlerësim të programit (shih Report of the expert team, May 2019, të bashkëngjitur në këtë RVV) kanë vlerësuar se: “kurrikula e Programit Master në Gjeodezi është e balancuar mirë, përputhet me programet studimore bashkëkohore ndërkombëtare dhe merr parasysh nevojat me të cilat Kosova ballafaqohet për shkak të zhvillimeve dhe perspektivave të fundit”. Programi MScGJ për nga procesi mësimor, kurrikula, përmbush objektivin strategjik të UP-ës, duke qenë konform kërkesave ndërkombëtare.

Standardi 4.3. Programi i studimit i nivelit Master në Gjeodezi është kompozuar nga grup lëndësh (shih grafiqet në vijim) të cilat përfshijnë të gjitha fushat që lidhen me hapësirën dhe matjet që realizohen për të pasqyruar këto hapësira neper harta. Gjithashtu për arsye të arritjeve teknologjike, ky program përfshin edhe matjet nga largësia qofte përmes sateliteve GNSS, gjithashtu edhe atyre që realizojnë imazhe apo edhe skenime laserike (LIDAR). Një vend të rëndësishëm në përmbajtje nxënë dhe përpunimi i të dhënave gjeohapësinore qofte tekstual njashtu edhe grafike si dhe menaxhimi tyre përmes Web GIS.

Studimet në programin e studimit MScGJ janë studime të rregullta, zgjasin dy vite (katër semestra) dhe përmbajnë 120 kredi (ECTS), me nga 60 kredi secili vit. Se si janë të shpërndara lëndët e programit nëpër vite studimi, mund të shihet në tabelat në vijim.

Tabela 4. Pasqyra e programit, kurikula e programit (Master shkencor ne Gjeodezi)

Viti I						
Semestri I			Orët/ Java			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS	Profesori
1	O	Sistemet referente gjeodezike	2	2	6	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
2	O	Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave	2	2	6	Prof.ass.dr. Ismail Kabashi
3	O	Gjeovizualizimi	2	2	6	Prof.ass.dr. Bashkim Idrizi
4	O	Infrastruktura e të dhënave hapësinore	2	2	6	Prof.ass.dr. Ymer Kuka
5	Z	Matematikë e aplikuar	2	2	6	Prof. dr. Abdullah Zejnullahu
6	Z	Gjuhë e huaj	2	0	3	Ardita Ibishi
7	Z	Fotogrametria e avancuar digjitale	2	1	3	Prof.dr. Murat Meha
Semestri II						
Semestri II			Orët/ Java			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS	Profesori
1	O	Sistemi i Navigimit Global Satelitor (GNSS)	2	2	6	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
2	O	Teoria e avancuar e gabimeve	2	2	6	Prof.dr. Murat Meha
3	O	Shkenca e gjeoinformacionit & analiza hapësinore	2	2	6	Prof.ass.dr. Bashkim Idrizi
4	O	Sistemet e informacionit kadastral	2	0	3	Prof.dr. Murat Meha
5	Z	Ekonomia e tregut të tokës	2	0	3	Prof.ass.dr. Ymer Kuka
6	Z	GIS dhe hulumtimet nga largësitë në mjedis	2	1	3	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
7	Z	Modelimi virtual kartografik	2	2	6	Prof.ass.dr. Bashkim Idrizi
Viti II						
Semestri III			Orët/ Java			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS	Profesori
1	O	Gjeodezia fizike dhe tektonika	2	2	6	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
2	O	Vrojtimi i Tokës	2	2	6	Prof.ass.dr. Bashkim Idrizi
3	O	Matjet inxhinierike (përfshihen minierat)	2	2	6	Prof.ass.dr. Ismail Kabashi
4	O	Menaxhimi i projekteve GIS	2	0	3	Prof.ass.dr. Ymer Kuka
5	Z	Web GIS	2	2	6	Prof.ass.dr. Bashkim Idrizi
6	Z	Sistemet informative të bujqësisë	2	0	3	Prof.asoc.dr. Perparim Ameti
7	Z	Sistemet e gjeoinformacionit në vendimmarrje	2	0	3	Prof.ass.dr. Ymer Kuka
Semestri V						
Semestri V			Orët/ Java			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U*	ECTS	Profesori
1	O	Tema e Diplomës	2	2	6	

Sipas statusit të UP-së, për çdo 1 ECTS kalkulohej 25 orë studimi. Një shembull i kalkulimeve të ngarkesës së studentit që reflekton se si i caktohen 3 ECTS për një lëndë shihet në tabelën në vijim.

Tabela 5. Shembull i përcaktimit të ngarkesës së studentit

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30

Teori/Punë në laborator/Ushtime	1	15	15
Puna praktike	6	2	12
Përgatitje për test intermediar			
Konsultimet me mësimdhënësin	1	2	2
Puna në terren	2	1	2
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	1	8	8
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			
Përgatitja për provim final			
Koha e vlerësimit (testi, kuisi, provimi final)			
Projektet, prezantimet, etj.	1	8	6
		Totali	75

Kompozimi i lëndëve në programin studimor MscGj është i ndarë në lëndët nga fusha e Gjeodezisë dhe hapësirës, Gjeoinformatikës, Vrojtimit të Tokës dhe shkencave të natyrës. Ndërsa sa i përket ndryshimeve nga akreditimi i fundit, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e ekspertëve të akreditimit janë më pak se 20% nga akreditimi paraprak. Ndryshimet e bëra përmbajnë:

- ✓ Në semestrin e dytë ka qenë lënda GIS në Mjedis, ndërsa tani është ndryshuar në GIS dhe hulumtimet nga largësitë në mjedis, ku janë integruar njësi mësimore nga hulumtimet nga largësitë me aplikim në monitorim të mjedisit, duke përfshirë menaxhimin e fatëkeqësive. Ky ndryshim është bërë edhe sipas rekomandimit të ekspertëve nga akreditimi i fundit, ku është kërkuar përfshirja e njësive nga fusha e vëzhgimit nga largësia.
- ✓ Në semestrin e tretë ka qenë lënda Procesimi i avancuar i imazheve dhe hulumtimet nga largësia, ndërsa tani është ndryshuar në Vrojtimit të Tokës. Syllabusi i lëndës ka mbetur pothuajse i njëjtë, ndërsa janë modifikuar disa njësi mësimore, duke përfshirë ato nga fusha e vrojtimit të Tokës nga hapësira.
- ✓ Sipas rekomandimit të ekspertëve lënda Matjet inxhinierike është modifikuar dhe plotësuar me njesitë mësimore nga fusha LIDAR, ku gjithashtu laboratori është pajisur edhe me skanerin laserik.
- ✓ Janë bërë freskime në syllabusin e lëndës Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave.

Studentët e programit të studimit MScGJ, gjatë ciklit të studimeve kanë mundësinë të vizitojnë kompani industriale nga fusha e gjeodezisë, kadastrit, GIS, fotogrametrisë, etj., me qëllim që të informohen mbi metodat dhe teknologjitë për matjen e tokës për qëllime të ndryshme si inxhinierike, kadastrit, monitorimit të mjedisit, etj. Vizitat studimore realizohen në kuadër të marrëveshjeve bashkëpunuese midis FN-ës me institucionet (organizatat) lokale [T3].

Programi MScGJ po ashtu ka bashkëpunime me kompani, institucione dhe organizata të sektorit publik dhe privat me të cilët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në nivel të UP-ës dhe FN-ës [T3]. Këto bashkëpunime synojnë në përmbushjen e kërkesave konform rritjes së nivelit kërkimor dhe profesional. Disa nga marrëveshjet bashkëpunuese (të tri viteve të fundit, por jo vetëm), nga të cilat përfitojnë studentët e programit MScGJ për punë praktike dhe përfitime kërkimore e profesionale, janë listuar në vijim dhe janë të bashkëngjitura në këtë

RVV. Për këto dhe të tjera marrëveshje bashkëpunimi, gjegjësisht për përshkrimin e tyre mund të referohemi në [T3].

- Memorandum bashkëpunimi i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Ndërtimtarisë lidhur me vlerësimin e gjendjes fizike të ndërtesave të dëmtuara në kuadër të kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz. 28 Qershor, 2021.
- Marrëveshje bashkëpunimi midis Universitetit të Prishtinës, përkatësisht midis Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) “Prishtina”.
- Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi midis, Fakultetit të Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës, dhe Institutit “INKOS” sh.a., 8 Janar, 2019, etj. [T3].
- Projekti i KE GEOBIZ.

Pas përfundimit me sukses të këtij programi, studentët do të jenë të aftë të:

- Zbaton njohuritë e gjeodezisë dhe gjeoinformatikës në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.
- Zbaton metodat e matjes dhe të përpunimit satelitor, ajror dhe LIDAR.
- Zbaton dhe interpreton të dhënat hapësimore që lidhen me mjedisin, gjeologjinë, bujqësinë, menaxhimin e fatkeqësive.
- Identifikon, formulon dhe zgjidhë problemet e vëzhgimit të tokës dhe hapësirës duke zbatuar parimet inxhinierike, shkencore dhe matematikore.
- Komunikon në mënyrë efektive me një sërë audiencash dhe interpretoni probleme të ndryshme dhe komplekse.
- Identifikon, formulon dhe zgjidhë problemet specifike në fushën e kadastrës dhe të drejtave pronësore
- Zhvillon analiza të adekuate, interpreton të dhënat dhe gjykon në fushën e inxhiniersë gjeodezike për të nxjerrë përfundime.
- Vendos sisteme të koordinatave kombëtare dhe datumit gjeodezik.
- Kontribuon në planifikimin, projektimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e problemeve të ndryshme të gjeoinformacionit.

Standardi 4.4. Të tëra lëndët e përfshira në programin MScGJ janë të përshkruara me syllabuse (në të cilat studentët kanë qasje nga faqja e fakultetit, gjegjësisht mund të gjinden përmes vegzës: <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1.67>), përmes së cilave qartësohen: përmbajtja bazë e lëndës, objektivat e lëndës, rezultatet e pritshme të nxënies, aktivitetet gjatë mësimdhënies, metodologjia e mësimdhënies, metodat e vlerësimit, rezultatet e të nxënit dhe literatura bazë e shtesë për fushën. Përshkrimet e syllabuseve për secilën lëndë në veçanti të programit MScGJ janë bashkëngjitur edhe në formë fizike në këtë raport vetëvlerësues. Ndërsa, materiali i lëndës, studentëve u ofrohet përmes SEMS-it, apo në formë fizike. Së fundi (si shkas i pandemisë është praktikuar) materiali ofrohet edhe përmes platformës virtuale Google Clasroom.

Standardi 4.5. Mësimdhënia në programin MScGJ ofrohet në gjuhën shqipe. Megjithatë, Universiteti me vendimin e Senatit, dhe me propozim të njësisë akademike, mund të organizojë ligjërata edhe në gjuhë të tjera zyrtare, dhe kjo është e përcaktuar edhe me dispozita të Statutit të UP-ës (shih Neni 141 në Statutin e UP-ës) [S1].

Standardi 4.6. Si mësimdhënës, stafi akademik ndërmerr çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që vlerësimet e tyre për student pasqyrojnë meritën e vërtetë të secilit student. Nisur nga tradita e gjatë për edukim dhe mentorim të mësimdhënësve në FN-ë, marrëdhënia mësimdhënës-student konsiderohet si një bashkëpunim ku secili merr përgjegjësitë për të gjykuar rezultatet e dëshirueshme dhe ato të arritura në mësim. Në fakt, marrëdhënia mësimdhënës-student në UP-ë është e rregulluar edhe përmes dispozitave ligjore të veçanta që ekzistojnë në Kodin e Etikës së Stafit Akademik, Neni 7 dhe Neni 8 [T4].

Standardi 4.7. Fakulteti në përgjithësi, e në kuadër të tij edhe programi MScGJ ka përgjegjësi për progres akademik të studentëve duke përfshirë shërbimet akademike të studentëve. Konkretisht, se si mësimdhënësia u ofrohet studentëve për secilën lëndë në veçanti në program, pasqyrohet kryesisht në syllabusin e lëndës përkatëse. Mësimdhënësia ka një qasje edukimi dhe profesionalizmi për secilën fushë në kurrikulë dhe për çdo grup studentësh. Edhe nëse në program ka pjesëmarrje të studentëve që u takojnë grupeve të ndryshme, mësimdhënësia adaptohet edhe për atë grup studentësh. Kjo, jo vetëm duke u thirrur edhe në dispozitat statutare si dhe në Kodin e Etikës së Stafit Akademik, Neni 8-pika 4, ku theksohet se “përgjegjësia e mësimdhënies dështon nëse zbatohet diskriminim ndaj grupeve të ndryshme të studentëve” [T4], por edhe falë përvojës së mësimdhënësve.

Standardi 4.8. Politikat dhe procedurat për konstatim të punës akademike të studentëve janë të përcaktuara me Statut të UP-ës, Neni 108 dhe 109 [S1] dhe me Rregullore për studime themelore të nivelit baçelor [R5]. Ndërsa, fakulteti është përgjegjës për të organizuar provimet si mënyrë e vlerësimit të dijes dhe vlerësimet e studentëve. Vet mësimdhënësi definon mënyrat e vlerësimit të studentit, gjithmonë në përputhje me metodat për përcaktim të suksesit akademik të definuara në Statut të UP-ës. Metodrat që mund të aplikohen janë: Provimi, kolokfiumi, punimi seminarik, praktika profesionale dhe/ose testi praktik gjatë ushtrimeve. Për secilën lëndë në kurrikulë të programit MScGJ janë të definuara metodat e vlerësimit në syllabuset e tyre. Mësimdhënësi qysh në orën e parë të ligjëratës u prezanton studentëve përmes syllabusit metodat vlerësuese gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësinxënies. Syllabuset, po ashtu janë të qasshme edhe në faqe të FN-ës për programin studimor MScGJ.

Standardi 4.9. Standardi i punës së kërkuar për të arritur nota të ndryshme është konsistent dhe i krahasueshëm në lëndët e kurrikulës së programit. Vlerësimi bëhet edhe me pikë apo me përqindje të të arriturave, për metoda të veçanta vlerësimi akademik të studentëve nga mësimdhënësi. Megjithatë, vlerësimi përfundimtar i studentëve definohet me nota (nga 5 si pamjaftueshëm; 6 si mjaftueshëm; 7 si mirë; 8 si shumë mirë si dhe 9 dhe 10 si shkëlqyeshëm) për të përshkruar nivelin e suksesit të përgjithshëm të studentit për lëndë. Notat përfundimtare vendosen në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve (SEMS).

Standardi 4.10. Kur sukcesi vlerësohet me notë të pamjaftueshme për herë të parë, një ndër veprimet që mund të ndërmerren, është mundësia e riprovimit të studentit në lëndën të cilën nuk e ka dhënë. Me këtë rast studentit ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provim të lëndës së njëjtë. Në rast të përsëritjes së mos suksesit të studentit, apo edhe pa kënaqësisë së studentit me notën e vlerësuar, atëherë studentit mund të veprojë sipas procedurave të përcaktuara në Statut të UP-ës, Neni 114 dhe Neni 115 [S1]. Në rast se rezultatet e vlerësimit të studentëve në mënyrë konsistente janë jo të kënaqshme, atëherë mësimdhënësi siguron

komunikim student-mësimdhënës për arritjen e rezultateve më të mira të mësimnxënies. Ky komunikim zhvillohet përmes konsultimeve me kërkesë të mësimdhënësit (në rastet kur rezultatet e mësimnxënies për disa herë vlerësimi nuk janë të kënaqshme) apo vet studentit/studentëve (konsultim për studentë me vlerësim të pamjaftueshëm apo studentë të pakënaqur me notë), për t'i eliminuar mangësitë e mësimnxënies.

Standardi 4.11. Në kurrikulen e programit MScGJ përfshihet në disa lënde puna praktike të cilat realizohen në terren me pajisjet të cilat i posedon laboratorit i gjeodezisë siç janë GNSS, Stacioni total, skaner 3D laserik, UAV, nivela etj.

Standardi 4.12. Realizimi i punës praktike, mundësohet edhe në kuadër të marrëveshjeve bashkëpunuese midis FN-ës [T3] me institucionet (organizatat) lokale (disa nga to të listuara në Standardin 4.3.), por jo vetëm. Puna praktike realizohet edhe me ndihmën e trupit këshilldhënës [T5] në kuadër të FN-ës, por edhe me ftesë me e-mail të kompanive, organizatave dhe/ose institucioneve për t'u mundësuar studentëve të MScGJ zhvillimin e punës praktike. Ftesat e tilla janë gjithmonë pozitive, e nganjëherë çojnë në bashkëpunim të vazhdueshëm qoftë me student apo mësimdhënës për bashkëpunim dhe përfitim reciprok akademik dhe profesional.

Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit mësimor:

A. Pikat e forta:

- Përmbajtje që përfshinë metodat e reja dhe teknologjitë moderne.
- Program i zhvilluar në përputhje me programin aktual Bachelor, si dhe në koordinim të plotë me universitete mirënjohura evropiane brenda projektit Tempus (KTH, UWH, AUTH, VGTU).
- Programi me përmbajtje të tillë të lëndëve u mundëson studentëve të Universitetit të Prishtinës të jenë konkurrentë me studentë të universiteteve të rajonit dhe universiteteve tjera ndërkombëtare.
- Planprogram i cili i përgjigjet kërkesave aktuale të tregut dhe i harmonizuar nga debatet me bordin industrial.

B. Dobësitë

- Orientimi i programit përfshin komplet fushën e gjeodezisë dhe gjeoinformacionit.

C. Mundësitë:

- Fleksibilitet për të inkuorporuar ide dhe koncepte të reja në kurrikulë të cilat shpërfaqen nga procesi vlerësues (në vijim).
- Zhvillimi i kapaciteteve të laboratorëve përmes projekteve hulumtuese dhe projekteve të tjera për ngritje të kësaj komponentë.
- Përmes projekteve të përbashkëta mund të propfilizohen programet e reja në bashkëpunim me departamentin e hidroteknikës dhe inxhinierisë së ambientit

D. Sfidat

- Kufizimet për arsye të COVID-19 dhe procedurave të vizave, mund të shkaktojnë ngecje në shkëmbim të stafit akademik dhe projekteve ndërkombëtare.

- Pajisja me teknologjite me të avancuara matëse dhe llogaritëse në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies
- Ngritja e kapaciteteve të mëtutjeshme shkencore dhe teknologjike me qëllim avancimin e mëtutjeshëm të këtij programi studimor

2.5. Studentët

Standardi 5.1. Pranimi i studentëve në programin MScGJ bëhet përmes thirrjes publike, për nënshtrim në provim pranues në Fakultetin e Ndërtimtarisë (FN). Kriteret pranuese për nivelin master të studimeve janë të specifikuara në thirrjen publike, të cilën thirrje e shpall Universiteti i Prishtinës në koordinim me secilën njësi akademike [R5]. Senati i Universitetit në përputhje me dispozitat e Statutit të UP-ës [S1] është përgjegjës për përcaktim të numrit të kandidatëve që do të pranohen në vitin e parë, duke konsideruar numrin e propozuar nga Këshilli i Fakultetit për programin MScGJ.

Standardi 5.2. Programi i studimit MScGJ u dedikohet kandidatëve që kanë përfunduar studimet Bachelor në një program 2- vjeçar me 120 ETCS. Ky grup i kandidatëve, të cilëve u ofrohet ky program studimi duhet të kenë përfunduar studimet për një diplomë në Bachelor në shkencat gjeodezike. Është Statuti i UP-ës, në kuadër të të cilit definohe në hollësi kushtet për pranim të studentëve në studime Master. Në nivel të UP-ës, ekziston Qendra për Zhvillim të Karrierës [T8], e cila ndër të tjera ka për qëllim edhe informimin e të interesuarve rreth studimeve në UP. Megjithatë, FN-ja duke qenë syhapur në numrin e studentëve që aplikojnë në programet e studimit në përgjithësi dhe në programin MScGJ, ka paraparë edhe në Planin Strategjik [S3] që të organizojë fushata për sensibilizim të studentëve të ardhshëm, të publikojë broshura njoftuese, të informojë në kohë reale nga tregu i punës për performancën e programit të studimit.


Standardi 5.3. Numri i studentëve aktual në programet e FN-ës është prezentuar në Tabelën mbi Studentët të bashkëngjitur në shtojcë të kësaj RVV-je. Numri i studentëve mundëson që mësimdhënia dhe mësimnxënia të zhvillohen në mënyrë efektive dhe interaktive duke aktivizuar të gjithë studentët dhe duke shtyer rritjen e rezultateve të dëshirueshme në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Sipas rregullores e cila ndër të tjera rregullon edhe çështjen e krijimit të grupeve për studentë [R12], grupi i studentëve dallon nëpër njësi akademike. Për Fakultetin e Ndërtimtarisë, grupi i studentëve për ligjërata është minimumi 10 dhe maksimumi 70; për ushtrime teorike minimum është 5 dhe maksimumi 25 studentë dhe për ushtrime laboratorike, minimum i grupit të studentëve është 6 dhe maksimumi është 12 studentë. Ky numër i studentëve në grup vlen për lëndë obligative. Numri i grupit dallon për lëndë zgjedhore.

Standardi 5.4. Studentët zhvillojnë studimet sipas planit me lëndë të përfshira në programin MScGJ dhe i nënshtrihen vlerësimeve sipas politikave të krijuara nga FN-ja dhe UP-ja në përgjithësi. Rezultatet e vlerësimeve ofrohen në vazhdimësi, në mënyrë të rregullt dhe transparente tek studentët për secilën lëndë. Vlerësimi përfundimtar me notim vendoset në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve (SEMS). Në rast të pakënaqësisë së studentëve me vlerësimin, atëherë studenti mund t'i refuzojë notën me mundësi rivlerësimi të performancës së tij akademike në vlerësimin e radhës, apo aplikohen mekanizma sikur edhe në Standardin 4.10 për arritje të rezultateve të dëshirueshme në mësimnxënie.

Standardi 5.5. Rezultatet e fituara nga studentët për secilën lëndë në veçanti ruhen nga mësimdhënësi përgjegjës përmes SEMS, shtypen si fletëparaqitje fizike, nënshkruhen nga mësimdhënësi dhe arkivohen në administratën e FN-ës. Sipas Rregullores së studimeve “studenti nuk mund t’i nënshtrohet provimeve të vitit aktual para se t’i përfundoj ato të vitit paraprak” [R5]. Prandaj, rezultatet e vlerësimeve arkivohen me qëllim shërbimi për student, administratë dhe menaxhment. Është SEMS sistemi [R6] me të cilin konfirmohet se studenti ka kryer obligimet e parapara me programin e studimeve. Kjo zhvillohet nga stafi administrativ, i cili regjistron provimet e kaluara në semestër dhe vit akademik dhe evidenton progresin e studentit të bërë nga viti në vit deri te diplomimi. Në fund të studimeve, studentit punon temën e diplomës duke vërtetuar të arriturat e të mësuarit dhe aplikimin e informatave të fituara gjatë studimeve lidhur me fushat me interes të inxhinierisë së ambientit. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve të nivelit baçelor në programin e studimit MScGJ fitohet thirrja akademike “Master i Gjeodezisë dhe Gjeoinformatikës” (Subject Code 07.6).

Standardi 5.6. FN në vazhdimësi shpall tri afate të rregullta publike në përputhje me Nenin 111 të Statutit të UP-ës, dhe ato: afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe afatin e vjeshtës (shtatorit). Po ashtu, për studentët të UP-ës, gjegjësisht FN-ës, organizohen edhe afate plotësuese në shërbim të studentëve të rregullt dhe studentëve absolutent. Kjo me qëllim që studentët të kenë mundësi të arrijnë rezultatet e pritshme në kohë të caktuar. Oraret për secilin afat provimi shpallen nga menaxhmenti i FN-ës, fizikisht në “dritaret” e FN-ës dhe në mënyrë elektronike në faqe te FN-ës, te “Oraret”. Mësimdhënësi dhe studentit duhet detyrimisht t’u përmbahen orarit të shpallur për provim. Studimet në MScGJ zgjasin dy vite, brenda të cilave studentit edhe duhet të diplomojë. Megjithatë, fleksibiliteti i politikave të përcaktuara në nivel të UP-ës i lejon studentit që t’i vazhdohet kohëzgjatja e afatit të diplomimit. Gjegjësisht, ekziston vendimi i lëshuar nga Senati i UP-ës në lidhje me vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit të diplomimit për studentët të nivelit baçelor, master dhe doktoratë [V2].

Standardi 5.7. Studentët gjatë studimeve mund të vlerësohen, si: me test, kollokfium, punë laboratorike, punë në teren, detyra shtëpie dhe me provim final (me gojë, me shkrim). Rezultatet e vlerësimeve bëhen publike për student, ruhen nga mësimdhënësi dhe në fund, përmbledhja e vlerësimeve (nëse janë shfrytëzuar mekanizma ndryshe nga provimi final) vendoset me notë në SEMS. Përmes SEMS-it [R6], gjenerohet raporti statistikor, e që pasqyron kalueshmërinë e studentëve. Nga ky raport statistikor mësimdhënësit reflektojnë mbi arritjen e objektivave gjatë mësimdhënies e mësimnxënies. Sikur edhe është cekur në Standardin 2.4. rezultatet e mësimnxënies të elaboruara përmes raportit statistikor luajnë rol me rëndësi në ngritjen e cilësisë së programit. Një ilustrim mbi kalueshmërinë e studentëve në një lëndë të caktuar, e që gjenerohet nga SEMS-i me llogari të veçantë për secilin mësimdhënësi, është paraqitur në grafikun në vijim.



Grafik 1. Pasqyrimi i kalueshmërisë së studentëve për lëndë nga mësimdhënësi

Standardi 5.8. Këtë vit, UP-ja përmes projektit ResearchCult ka siguruar qasje në softuerin Plagiarismcheck, sistem i cili përdoret nga stafi duke ndihmuar në detektimin e plagjiatit, sidomos për temat e diplomës së nivelit master. Megjithatë, me qëllim të mbrojtjes nga rezultatet e falsifikuara (sajuara), kopjimet dhe dyshimet eventuale të punës akademike të studentit ekzistojnë komisione brenda njësisë akademike (etike dhe disiplinore) përmes të cilave procedohet çdo shkelje e llojit të tillë. Po ashtu, për procedurat dhe përgjegjësisë disiplinore për studentët e UP-ës ekziston edhe rregullorja e veçantë [R11] e lëshuar nga UP-ja.

Standardi 5.9. Dispozitat e Statutit të UP-ës (i cili është dokument publik në faqe të universitetit), përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e studentëve. Në nivel të UP-ës, ekziston parlamenti i studentëve [R11], ndërsa në nivel të fakultetit ekziston këshilli i studentëve [T7]. Studentët përfaqësues të këtyre organeve përfshihen në promovimin dhe mbrojtjen e interesave të studentëve në nivel të UP-ës dhe të fakultetit; në zhvillim të cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit, në pajtim me Statutin e UP-ës; dhe në aspekte të reformave të UP-ës dhe fakultetit si dhe zhvillimeve akademike në interes të studentëve. Përgjithësisht, këto organe janë në shërbim të interesave të studentëve që përfaqësohen në kuadër të UP-ës dhe fakultetit. Po ashtu, në shërbim të studentëve dhe të diplomuarve nga UP-ja, por jo vetëm, është edhe Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) e cila ka për qëllim që të ofrojë mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit, ndërmjetësisimit me punëdhënësin, ofrimit të këshillave akademike dhe aktiviteteve të tjera. Informatat për aktivitetet, pjesë e të cilave mund të jenë edhe studentët e edhe të diplomuarit, u përcillen me e-mail nga QZHK [T8]. Edhe FN-ja në kuadër të kësaj qendre posedon faqen “e-Karriera” [T9], përmes së cilës studentët mund të njoftohen për informatat e fundit rreth trajnimeve, punëve praktike, panairove, këshillave dhe aktiviteteve të tjera.

Standardi 5.10. Transferi i studentëve rregullohet në bazë të Nenit 142 (Ndërrimi i drejtimit të studimeve) të Statutit të UP-ës [S1]. Me këtë Statut janë të rregulluara edhe procedurat e njohjes dhe transferit të ECTS kredive nga institucionet tjera dhe brenda njësisë të UP-ës. Po ashtu, për njohje dhe transferim janë në përdorim edhe dokumentet relevante me to (marrëveshja e mësimit, transkripti i notave, shtojca e diplomës).

Në kuadër të programeve të bashkëpunimit shkencor dhe arsimor të Universitetit të Prishtinës me Universitete të tjera Ndërkombëtare, edhe Fakultetit të Ndërtimtarisë me të gjitha programet studimore i mundësohen studime në çfarëdo fushe të interesit me bursa për nivele studimore: baçelor, master apo doktoratë. Nga këto programe bashkëpunimi, qoftë nga UP-ja [T2], apo vet FN-ja [T3], për vazhdim të studimeve master, kanë përfituar edhe studentë të programit MScGJ. Përmes programit ERASMUS+ Mobility të Komisionit Evropian, studentëve të interesuar u janë ofruar bursa mobiliteti në Universitete Ndërkombëtare. Gjatë vitit akademik 2019/2020, dy studentë nga niveli Bachelor kanë kryer nga një semestër në Universitetin e Munchenit dhe Milanos.

Disa nga studentët e programit BScGJ të përzgjedhur si përfitues të bursave kanë vazhduar studimet në ciklin e radhës, në studime master, në universitete të ndryshme, dhe atë:

- Në Universitetin politeknik të Milanos, në Itali.
- Në TU Delft drejtimi Vëzhgimi nga largësia
- Në Universitetin e teknik të Munchenit

Standardi 5.11. Për shërbime të studentëve në lidhje me mësimdhënien dhe mësimnxënien në programin MScGJ, stafi akademik e ka detyrim sikur edhe i tërë stafi në UP (sipas Rregullores për studime themelore baçelor) të ofrojë konsultime minimumi dy herë në javë nga një orë. Ky orar konsultimi nganjëherë edhe tejkalohet në rast të mentorimit të temave të diplomës, hulumtimeve apo nevojës së studentit/mësimdhënësit për të arritur rezultat të kënaqshëm vlerësimi. Në kohë pandemie (COVID-19), konsultimet janë ofruar edhe virtualisht, përmes platformës GoogleMeet. Udhëzimet për zhvillimin e aktiviteteve akademike gjatë pandemisë janë përcaktuar me vendim të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës [V3].

Për t'u informuar rreth arritjeve shkencore, studentët kanë çasje në librarinë digjitale "Science Direct", të shtëpisë botuese me renome – Elsevier (shih Faqen ScienceDirect, në Uebsajtin e UP-së: <https://www.uni-pr.edu/>). Nga Dhjetori i 2018, studentët kanë mundësi të gjejnë materiale elektronike edhe në Bilblotekën Qendrore Kombëtare përmes platformës LibApps të krijuar nga Universiteti i Prishtinës në kuadër të projektit Erasmus +, "Library Network Support Services". Më konkretisht, këto materiale mund t'i gjejnë përmes vegzës [Fillimi - Biblioteka Qendrore Universitare - LNSS Platform at LNSS Western Balkans \(libguides.com\)](#).

Analiza SWOT për studentët:

A. Pikat e forta:

- Informim përmes mekanizmave të ndryshëm për përmbajtjen dhe zhvillimet akademike në programet e FN-ës.
- Aktivitetet e studentëve në kuadër të kurrikulës janë kompatible me aktivitetet në kurrikulat ndërkombëtare të fushës.
- Mundësi mobiliteti në Universitete Ndërkombëtare.
- Qasje në revista shkencore përmes librarisë digjitale ScienceDirect të ofruara nga UP-ja.

B. Dobësitë:

- Kufizimet e lirisë së lëvizjes në vendet e Bashkimit Evropian.
- Hapësirë e vogël në bibliotekën fizike të fakultetit.

C. Mundësitë:

- Mobilitet i mëtutjeshëm i studentëve përmes projekteve hulumtuese.
- Qasje në libraritë digjitale.

D. Sfidat:

- Vështirësi në mësimnxënie dhe punës në laboratore për arsye të pandemisë (COVID-19).
- Ngecja e mobilitetit studentor për arsye të buxhetit dhe pandemisë.
- Shkëmbim i studentëve me Universitetet jashtë Kosovës si mungesë e procedurave burokratike të vizave.

2.6. Hulumtimi

Standardi 6.1. Universiteti i Prishtinës, në kuadër të Planit Strategjik [S2] ka të inicuar edhe nxitjen për hulumtime kërkimore shkencore/artistike. Në fakt, Universiteti i Prishtinës së fundi ka aprovuar Rregulloren për përkrahje financiare për hulumtime. Kjo rregullore parasheh që të paktën 1% e buxhetit vjetor të UP-së t'i dedikohet drejtpërdrejtë avancimit të komponentit kërkimor e shkencor në UP (Tabela në vijim, pika 1). Megjithatë, FN-ja ka avancuar me hulumtime shkencore të përkrahura përmes granteve-programeve dhe projekteve ndërkombëtare.

Përprjekjet për të sjellur projekte të reja shkencore vazhdojnë dhe janë strategji e FN-ës për cilësi të qëndrueshme. Kështu, FN-ja, gjegjësisht departamenti i Gjeodezisë tashme ka aplikuar me një projekt propozim në programin “HORIZON-WIDERA-2021-ACCESS-02” (Acronym: RS4LAWA; Number: 101059976; Duration: 36 months). Po ashtu, në UP këtë fund vit (2021), planifikohet edhe ndarja e buxhetit për njësi akademike. Në kuadër të kësaj, FN-ja në koordinim me departamentet brenda saj është kërkuese e një buxheti mirë të planifikuar, që do të mbështesë komponentën e hulumtimeve shkencore në FN. Nga ky buxhet, përfitues do të jenë të gjitha programet e studimit të FN-ës, me plan të një projekti me përfshirje të të gjitha departamenteve.

Standardi 6.2. Mësimdhënësit e përfshirë në programin MScGJ janë të përzgjedhur përmes politikave të hartuara nga Universiteti i Prishtinës. Kjo do të thotë se, mësimdhënësit e përfshirë, përpos kriterëve të tjera të kërkuara, plotësojnë edhe kriterin e aktivitetit hulumtues, shkencor dhe profesional i cili është në pajtueshmëri me dispozitat mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, që janë të përcaktuara në Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës [R2] (shih CV-në për mësimdhënësin në vegzën: <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,14>, apo tabelën “Lista e punimeve dhe projekteve shkencore”, të bashkëngjitur në shtojcë të kësaj RVV-je).

Standardi 6.3. Sigurisht se politikat e definuara për avancime të mësimdhënësve bazohen në hulumtime me recension ndërkombëtar dhe të indeksuara në databazat si: Science Citation Index Expanded, Social Sciences Citation Index dhe Arts & Humanities Citation Index, përmes platformave Web of science dhe Scopus (Elsevier). Hulumtimet dallojnë nga fusha në fushë, dhe si të tilla ato shfrytëzojnë ose të dhëna të fituara në laboratore përkatëse (të FN-ës apo të vet modeluara si modele fikzike), ose të dhëna të kërkuara nga institucionet përkatëse.

Standardi 6.4. Stafit akademik interesin e hulumtimit e shtrin në atë të studimit. P.sh. mësimdhënësi i cili fushë interesi ka aplikimin e GIS dhe ndijim nga largësia (që edhe ligjëron në programin MScGJ), hulumtimet i ka të zhvilluara me fokus në po këto fusha. Apo, mësimdhënësi i matjeve satelitore GNSS dhe të tjerë (shih CV-në për cilin do mësimdhënësin në vegzën: <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,14>, apo tabelën “Lista e punimeve dhe projekteve shkencore”, të bashkëngjitur në shtojcë të kësaj RVV-je).

Standardi 6.5. Stafit akademik i FN-ës hulumtimet i publikon në: revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare të cilat plotësojnë kushtet si në paragrafë të definuar në Rregulloren për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik të UP-ës; në kapituj të librave vendor dhe ndërkombëtar; në kongrese, konferenca, simpoziume, seminare dhe workshope në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Standardi 6.6. Ka hulumtime që kanë të bëjnë me të dhëna vendore (ekzistuese apo aktuale) të cilat monitorohen në laborator të FN-ës, apo në laboratore të institucioneve me të cilat FN-ja ka marrëveshje bashkëpunimi. Në këtë rast, ato të dhëna validohen për siguri dhe kontrollë të rezultateve nëse kanë pasur gabime gjatë analizave. Kjo vërtetësi arrihet edhe nga përvoja e mësimdhënësve në punën e zhvilluar profesionale praktike. Kur hulumtimet kanë të bëjnë me krahasueshmëri apo rishiqim (review) të literaturës në lidhje me një problematikë të veçantë, atëherë ato vërtetohen përmes botimeve kërkimore shkencore dhe aplikative. Stafit dhe studentët e programit MScGJ zhvillojnë hulumtime që janë të lidhura direkt me përdorim praktik apo që janë të lidhura ngushtë me nevojat e tregut dhe interesin shoqëror. Hulumtimet, të cilat përfshijnë pjesën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kryesisht janë të drejtuara në disa fusha, si:

- Definicioni i sistemeve referente gjeodezike.
- Aplikimi i GIS-it në përdorimin e tokave, mjedisit, agrikulturës, pylltarisë, etj.
- Përcaktimi i modeleve të ndryshme të tokës.
- Analizë e deformimeve duke përdorur teknika satelitore .
- Fotogrametri dhe analizë me sensorë nga largësia .
- Kartografimi digjital.

Standardi 6.7. Stafit akademik në FN, me qëllim të ngritjes së cilësisë akademike, ka si detyrim që të publikojë numër të caktuar të punimeve hulumtuese, dhe atë së paku 1 punim në vit, për tri vite. Përpyekjet vazhdojnë për më shumë publikime cilësore.

Standardi 6.8. Emri i Universitetit të Prishtinës, gjegjësisht i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Departamenti në veçanti, specifikohen në hulumtimet e publikuara të safit akademik të FN-ës. Edhe e drejta për mbështetje financiare nga UP-ja (Rregullore për financimin e veprimtarisë kërkimore shkencore, artistike dhe sportive në UP) i takon artikujve që bartin adresën e Universitetit të Prishtinës (affiliations).

Standardi 6.9. Me qëllim të ngritjes së performancës në mësimnxënie, mësimdhënësi në vazhdimësi integron jo vetëm përvojën praktike profesionale në ligjërata, por në kuadër të njësisë apo fushës së lëndës që ligjërohet i informon studentët për informata të punimeve-hulumtimeve (si raste studimore) të zhvilluara e të publikuara në revista apo konferenca. Hulumtimet e mësimdhënësve, i mundësojnë programit në veçanti dhe fakultetit në përgjithësi

sjelljen e po asaj eksperience hulumtimi në klasë si burim i problemeve të botës reale dhe çështjeve të kohës (bashkëkohore).

Standardi 6.10. Është Senati i UP-ës të cilit i takojnë përgjegjësitë në lidhje me zhvillimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale të UP-ës dhe shfrytëzimin komercial të saj. Dhe sipas të drejtave dhe përgjegjësiave të personelit (dispozitë e Statutit të UP-ës): “personeli akademik ka lirinë për të publikuar rezultatet e punës së tyre kërkimore dhe krijuese, që kushtëzohet me rregulloret e këtij Statuti që ka të bëjë me përdorimin e të drejtave të pronës intelektuale për dobi të Universitetit” [S1]. Nëse e drejta e autorit dhe e etikës në publikime shkencore shkelet, apo keqpërdoren fondet e besuara publike për përfitime personale ose në interes të personave të tjerë, atëherë këto çështje janë të rregulluara me Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP-ës [R8].

Standardi 6.11. Shumë nga studentët e programit MScGJ pas përfundimit të studimeve kanë vazhduar dhe planifikohet të jenë pjesë e aktiviteteve të ndryshme, dhe atë:

- Disa studentë të programit MScGJ është paraparë që të përfshihen në projektin me të cilin FN-ja, gjegjësisht departamenti i Gjeodezisë ka aplikuar në programin “HORIZON-WIDERA-2021-ACCESS-02” (Acronym: RS4LAWA; Number: 101059976; Duration: 36 months). Rezultatet e vlerësimit të projekt propozimeve pritet të komunikohen në Janar të vitit 2022.
- Në projekt të GIZ-Kosovo, si vazhdimësi e punës praktike.
- Ne pune praktike ne Agjencinë Kadastrale të Kosovës.
- Në kompani te licencuar për gjeodezi, aplikim te GIS dhe hartografi.

Aktivitetet e tilla pas përfundimit të studimeve, duke mos anashkaluar edhe zhvillimin e punës praktike gjatë studimeve, u kanë ofruar mundësi studentëve të krijojnë kontakte me të punësuar dhe ekspertë të institucioneve, kompanive e organizatave. Në këtë mënyrë, kontaktet e tilla janë bërë derë e hapur punësimi për studentët e programit MScGJ.

Niveli Master i programit MScGJ përmbillet me punimin e temës së diplomës, e cila është kryesisht punë hulumtuese individuale. Puna e temës së diplomës mund të organizohet edhe nga grup studentësh për hulumtim në një fushë të caktuar. Një pjesë e hulumtimit mund të zhvillohet në bashkëpunim me ndonjë institucion relevant me subjektin e temës. Kontakti bashkëpunues midis studentit dhe institucionit mund të arrihet edhe me ndihmën e trupit këshillëdhënës në kuadër të FN-së, por edhe me bashkëpunime të arritura në kuadër të punës praktike.

Analiza SWOT për hulumtim:

A. Pikat e forta:

- Stafit akademik aktual ka një eksperience aktive ndërkombëtare bazuar në shkëmbimet shkencore dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në projektet hulumtuese.
- Progresi i punimeve të publikuara të publikuara në revista të indeksuara në databaza të platformave të besueshme.
- Qasja në revista shkencore përmes librarisë digjitale Science Direct të ofruara nga UP-ja.

- Qasja në revista shkencore përmes librarisë digjitale Science Direct të ofruara nga UP-ja.
- Mundësia e shfrytëzimit të laboratorëve të pajisur shumë mire për hulumtime shkencore.
- Njohuritë e mira të gjuhëve të huaja nga stafi akademik dhe studentët është përparësi për bashkëpunim ndërkombëtar.

B. Dobësitë:

- Mungesa e ndarjes kohore (Normativi), apo orëve punuese në nivel institucional për aktivitete arsimore (mësimdhënie), hulumtuese-shkencore-profesionale, zhvillim institucional dhe shërbim të komunitetit.
- Nxitja për publikime nga politikat e UP-ës, dhe buxhet i pamjaftueshëm nga UP-ja për hulumtime.

C. Mundësitë:

- Bashkëpunimi ndërkombëtar në projekte të cilat ofrohen nga BE sidomos për Ballkanin Perëndimor.
- Krijimi i mundësive për publikime përmes projekteve të përbashkëta hulumtuese.
- Përfshirja e studentëve dhe shkencëtarëve të rinj në projekte hulumtuese.
- Bashkëpunimi i FN-ës me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

D. Sfidat:

- Zhvillimi i mundshëm i hulumtimeve përmes financimit vetanak, apo përmes projekteve hulumtuese në të cilat duhet aplikuar.
- Shkurtime të buxhetore mënjanojnë participimet në projektet hulumtuese.

2.7. Infrastruktura dhe burimet

Standardi 7.1. Fakulteti i Ndërtimtarisë është një nga njësitë akademike brenda Universitetit të Prishtinës i cili ndan hapësirë të përbashkët edhe me dy njësi të tjera akademike: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Komjuterike (FIEK) dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM). Të trija njësitë akademike funksionojnë në hapësirë të përbashkët që identifikohet si “Fakultet Teknik” ose “Kampusi Teknik”. Fakulteti Teknik posedon objektin kryesor dhe objektin e laboratoreve. Të trija njësitë akademike (FN, FIEK dhe FIM) të UP-së ndajnë hapësirën e objektit kryesor në mënyrë proporcionale. Sipërfaqja totale që i takon Fakultetit të Ndërtimtarisë është rreth 8,600 m², përfshirë hapësirat në objektin kryesor dhe ato në objektin e laboratoreve. Sipërfaqen e objektit kryesor, prej përafërsisht 5,156 m² e zënë hapësirat e përbashkëta të komunikimit (korridoret, shkallët, nyjet sanitare, biblioteka etj), amfietatrot, sallat e mësimi, zyret e mësimdhënësve (kabinetet), zyret e administratës, zyra e TI, zyret e menaxhmentit dhe hapësirat e tjera ndihmëse. Ndërkaq, hapësira e objektit të laboratoreve të ndërtimtarisë që është shumë afër objektit kryesor të Fakultetit të Ndërtimtarisë zë sipërfaqe prej 3,369 m². Laboratori: i gjeodezisë, gjeomekanikës, i materialeve dhe asfaltit, dhe i hidroteknikës e inxhinierisë së ambientit janë laboratore për nevoja të mësimi për të cilat janë bërë investime kapitale.

Programi studimor MscGJ shfrytëzon 4 hapësira të laboratorëve: dy laborator me PC të cilët janë të vendosur në ndërtesën kryesore, si dhe dy në hapësirat e objektit të laboratorëve. Njeri

nga laboratorët është i pajisur me PC dhe pajisje fotogrametrike, ndërsa laboratorit tjetër përmban pajisje gjeodezike, LIDAR, UAV, software dhe me te gjitha pajisjet tjera përcjellëse (GIS..).

Hapësirat në objektin kryesor të Fakultetit Teknik, që i takojnë Fakultetit të Ndërtimtarisë nga ndarja proporcionale me dy fakultetet e tjera (FIEK dhe FIM) janë: Niveli me nr. 500 i objektit me salla mësimi, zyre të mësimdhënësve, hapësira të përbashkëta për komunikim – korridore, nyje sanitare etj. Në këtë nivel të objektit gjendet edhe biblioteka e fakulteteve; Niveli me nr. 400, me hapësirat e përbashkëta të fakulteteve – korridoret e mëdha, nyjet sanitare, depot, etj. Pjesa më e madhe e administratës së FN-ës, shërbimet e studentëve, sekretaria, zyret e menaxhmentit si dhe amfiteatrot (415 dhe pjesërisht 408) gjenden në këtë nivel. Në këtë nivel është hyrja kryesore për në objekt; Niveli me nr. 300, që numëron sallat e mësimi, zyret e administratës së FN-ës ku zhvillohet veprimtaria për shërbime të studentëve, zyra e TI, korridoret, shkallët, nyjet sanitare, etj.; Niveli me nr. 700, mejanë zyret e mësimdhënësve dhe hapësirat e përbashkëta. Secili mësimdhënës në marrëdhënie të rregullt pune në FN posedon zyren e tij me gjithë en-terierin e nevojshëm (tavolinën e punës, pajisjet e domosdoshme për punë, kompjuter, printer, telefon). Po ashtu secila zyre ka të instaluar edhe ujin. Secila sallë mësimi është e pajisur me projektor dhe me mjete konkretizimi në shërbim të mësimdhënies.

Të dhëna më të detajuara mbi destinimet e hapësirave dhe sipërfaqet e tyre janë prezentuar në tabelën “Hapësirat dhe pajisjet”, e bashkëngjitur në shtojcë të kësaj RVV-je.

Standardi 7.2. Planifikimi i buxhetit për Fakultetin e Ndërtimtarisë, në kuadër të të cilit zhvillohet edhe programi MScGJ përfshin edhe planin financiar që mbulon shpenzimet për personel të punësuar në FN-a (staf akademik, administratë, bashkëpunëtorë), dhe shpenzimet në kategoritë e tjera ekonomike për vitet në vijim, janë prezentuar në tabelën “Plani i buxhetit dhe financimi për FN”, të bashkëngjitur në shtojcë të kësaj RVV-je.

Standardi 7.3. Të gjitha hapësirat në shërbim të Fakultetit të Ndërtimtarisë janë pronë e UP-ës. Fakulteti i Ndërtimtarisë nuk shfrytëzon hapësirë me qira. Edhe pse kampusin e Fakultetit Teknik e shfrytëzojnë tri fakultete: Fakulteti i Ndërtimtarisë (FN), Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) megjithatë, secilit fakultet i takon 1/3 e hapësirës së përgjithshme. Hapësirat që nuk mund të ndahen në mënyrë proporcionale në pronësi atëherë ato hapësira shfrytëzohen me rotacion proporcionalisht në kuptimin kohor.

Edhe hapësirat e laboratorëve e edhe pajisjet laboratorike janë pronë e Universitetit të Prishtinës. Vit pas viti UP-ja investon pjesërisht në riparimin dhe funksionalizimin e hapësirave edhe të objektit tonë, FN-ës. Në vitin 2018 janë bërë investime në rregullimin e ambienteve të hapësirave në pjesën e objektit të Laboratorëve (pjesa e gjeodezisë dhe laboratoreve të tjera). Investime të tilla zhvillohen edhe aktualisht (2021) në renovimin e laboratorit të hidroteknikës dhe inxhinierisë së ambientit. Serverët dhe softuerët që posedon FN-ja po ashtu kanë licencë përdorimi. Në FN ekzistojnë: serveri i bazës së të dhënave (rezultuar nga granti i projektit “InWaterSense”) dhe serveri i departamentit të gjeodezisë (rezultuar nga donacioni i UP-ës). Disa nga softuerët që posedon FN-ja janë: Softueri i GIS (ArcGIS), softueri për përpunimin e imazheve ajrore dhe satelitore (Erdas Imagine) dhe softueri për përpunimin dhe analizën e matjeve GNSS (TTC). Në vitin 2021 përmes projektit [GEOBIZ](#) (Erasmus +) ku departamenti

i gjeodezisë ishte partner ka përfituar një Dron të pajisur me kamerë dhe GPS si dhe një pajisje Laser Scanner.

Në objektin e të tri fakulteteve ekziston biblioteka e cila posedon sallat e leximit dhe literaturë, por nuk i plotëson kërkesat e mjaftueshme për studentë të FN-ës. Në të ardhmen, është e nevojshme dhe urgjente rritja e kapaciteteve të bibliotekës ose edhe eventualisht të ndërtohet objekti i saj – biblioteka Teknike.

Për të gjitha objektet e shfrytëzuar dhe paisjet laboratorike FN-ja posedon dokumentet adekuate. Të dhëna më të detajuara mbi pajisjet dhe sasinë e tyre janë prezentuar në tabelën “Hapësirat dhe pajisjet”, e bashkëngjitur në shtojcë të kësaj RVV-je.

Standardi 7.4. Fakulteti i Ndërtimtarisë me programet e tij posedon sipërfaqe të konsiderueshme të sallave të mësimi, laboratoreve, të cilat kanë kapacitet të mjaftueshëm për ulëse për studentë. Shikuar numrin e studentëve aktiv brenda FN-ës (numri total i studentëve në të gjitha programet e studimeve në FN) rreth 1231 në raport me sipërfaqen totale të objektit kryesor që i takon FN-ës është 5,156 m²/1,231, atëherë sipërfaqja e objektit për një student është 4.18 m², i cili është tregues i mirë i performancës.

Standardi 7.5. Biblioteka e fakultetit posedon numër të mjaftueshëm të vendeve (të paktën 10%) krahas numrit të përgjithshëm të studentëve në programin MScGJ. Në përgjithësi salla e leximit numëron 180 vende për lexim. Ky numër i ulëseve edhe pse plotëson nevojat për programin MScGJ në veçanti, në përgjithësi është numër i mangët për plotësimin e nevojave të të gjitha programeve në FN-a. Edhe dhomat e punës në grup kanë kapacitet për të akomoduar më shumë se 10% të numrit të përgjithshëm të studentëve të vetëm një programi në FN. Kjo nënkupton se është më se e nevojshme të zgjerohet/shtohet kapaciteti i bibliotekës për nevoja të përgjithshme të të gjitha programeve studimore në FN.

Në bibliotekën e objektit teknik, ekziston një numër i konsiderueshëm i librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe angleze, por mungojnë tekste profesionale të reja (literaturë e fundit për fusha përfshirëse në programe të FN-ës).

Standardi 7.6. FN-ja bashkë me dy fakultetet tjera teknike (FIEK dhe FIM) në vazhdimësi mundohen që të përshtasin infrastrukturën dhe objektet edhe për studentë me nevoja të veçanta. Tre katet e objektit mund të arrihen më një ashensor modern. Kati përdhës dhe hyrja kryesore e objektit është e qasshme për të gjitha mjetet që përdorin personat me nevoja të veçanta.

Gjendja dhe kushtet teknike që kampusi i teknikut i ofron janë të tilla që (duke llogaritur kohën e shfrytëzimit të objektit nga fillimi i shfrytëzimit 1982 deri sot – 39 vite) mesatarisht plotësojnë nevojat e punës për njësit tona akademike. Në 5 vitet e fundit janë realizuar investime në përmirësimin e kushteve dhe ambienteve të punës. Vlen të përmendet përmirësimi i ngrohjes, funksionimi i rrjetit të ngrohjes i cili ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e kushteve për mësimdhënie të rregullt në sallat e mësimi. Në vitin 2018 nga Investimet e Bankës Botërore, programi për efikasitet të energjisë, është investuar në fasadën termike dhe dritareve të objektit. Vit pas viti UP-ja investon pjesërisht në riparimin dhe funksionalizimin e hapësirave edhe të Objektit tonë. Në vitin 2018 janë bërë investime në rregullimin e ambienteve të hapësirave në pjesën e objektit të laboratorëve (pjesa e laboratorit të gjeodezisë), ndërsa këtë vit është duke u renovuar edhe pjesa e laboratorit të hidroteknikës dhe inxhinierisë së

ambientit), si dhe labororet tjera. Shërbimet e mirëmbajtjes dhe sigurimit të hapësirave të brendshme të FN-ës, bëhen nga kompanitë e shërbimeve përkatëse, të jashtme dhe të përzgjedhura në nivel Universitar.

Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:

A. Pikat e forta:

- Hapësirë e mjaftueshme për zhvillim të procesit mësimor.
- Laborator te pajisur me pajisje te sofistikuara për matje, përpunim dhe interpretim të të dhënave.
- Mundësi në librari digjitale ScienceDirect.

B. Dobësitë:

- Hapësira e pamjaftueshme për bibliotekë fizike.
- Mungesa e teksteve në bibliotekë.
- Mungesa e hapësirave për studim të pavarur nga ana e studentëve.
- Mungesa e hapësirave relaksuese dhe rekreacionale të studentëve.
- Mungesa e stafit – laborantëve në laboratore.

C. Mundësitë:

- Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për hulumtim dhe mësimdhënie, me qëllim të furnizimit të bibliotekës me libra dhe laboratorëve me pajisje.
- Rritja e mundësisë së qasjes në platforma digjitale nga Studentët-E library.
- Ngritja e cilësisë së mirëmbajtjes së hapësirave për aktivitetet e procesit të mësimi.
- Zgjerimi i laboratorëve me teknologji te larte (UAV..)

D. Sfidat:

- Shkurtime buxhetore mund te krijojnë vështirësi në mirëmbajtjen e infrastrukturës aktuale dhe krijimit të asaj të re.

3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM

Rekomandimi i Ekipit të Ekspertëve në Raportin e mëparshëm të Rishikimit të Jashtëm	Zgjidhja që ofruesi ka zbatuar në adresimin e rekomandimit	Komentet e tjera relevante
1.1 Misioni, objektivat dhe administrimi – Plotësisht i përbushur		
<i>Dimesnioni hulumtues i misionit të programit duhet të reflektojë në veprime më të qarta dhe konkrete.</i>	Misioni i Fakultetit të Ndërtimtarisë (FN) përcjellë në vazhdimësi Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës (UP), i cili synon nxitjen e kërkimit shkencor për mësimdhënësit dhe studentët. Universiteti i Prishtinës së fundi ka aprovuar rregulloren për përkrahje financiare për hulumtime. Kjo rregullore parasheh që të paktën 1% e buxhetit vjetor të UP-së t'i dedikohet drejtpërdrejtë avancimit të komponentit kërkimor e shkencor në UP. UP-ja sipas Planit Strategjik në kuadër të objektivit për rritje të rezultateve kërkimore parasheh edhe mbështetjen e përvetësimit të granteve kërkimore/shkencore nga agjencitë kombëtare të financimit dhe institucionet private dhe publike. Në kuadër të këtij plani edhe FN-ja ka për qëllim të rrisë rezultatet e kërkimit shkencor duke raportuar në baza vjetore për rezultatet e arritura.	Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-së, Menaxhmenti i FN-së dhe Shefi i departamentit.
<i>Në RVV të përfshihet një listë e titujve dhe përmbajtje e shkurtër e rregulloreve dhe udhëzimeve ekzistuese në anglisht.</i>	RVV e vitit akademik 2021/2022 veç ka marrë parasysh dhe e ka zbatuar këtë rekomandim.	Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-së, Menaxhmenti i FN-së dhe Shefi i departamentit.
1.2 Menaxhimi i cilësisë – Në thelb i përbushur		
<i>Vlerësimi i cilësisë duhet të jetë publikisht i qasshëm. Si mjet për menaxhim të cilësisë do të mund të ishte një faqe interneti.</i>	Sigurimi i cilësisë në FN-a mbështetet në instrumentet për sigurim të cilësisë të UP-ës. Vlerësimi i cilësisë ofrohet nga anketa për vlerësim nga studentët për lëndët, mësimdhënësit dhe administratën e që gjendet në Udhëzues për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimin e rezultateve të tyre. Me qëllim të kontrollit të aktiviteteve akademike të zhvilluara nga stafi akademik shfrytëzohen edhe pyetësor anonim të formuluar nga rektorati, të plotësuar nga studentët. Përmes këtyre pyetësorëve vlerësohet edhe stafi akademik, e edhe lënda. Po ashtu vlerësohen edhe shërbimi dhe infrastruktura dhe personeli administrativ dhe mbështetës i UP-ës. Në këta pyetësor studentit ka mundësi të jap vlerësimin e tij për çdo lëndë në veçanti, përfshirë edhe vlerësimin për mësimdhënësin e lëndës. Vlerësimi i mësimnxënies si parametër i cilësisë zhvillohet nga SEMS-i, prej të cilit gjenerohet raporti statistikor, e që pasqyron kalueshmërinë e studentëve. Nga ky raport	Në vazhdimësi. Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës.

	statistikor mësime të reflektuar mbi arritjen e objektivave gjatë mësimit e mësuesit.	
1.3 Stafit akademik – Në thelb i përbushur		
<i>Një prezantim tabelar i stafit duke përfshirë të gjitha specifikat e nevojshme sipas Standardit 3.1 duhet të përfshihet në RVV.</i>	RVV e vitit akademik 2021/2022 veç ka marrë parasysh dhe e ka zbatuar këtë rekomandim. Tani më në RVV, Standardin 3.1. është pasqyruar Tabela “Profilat e mësuesve të përfshirë në programin MScGJ”.	Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës dhe Shefi i departamentit.
<i>Vlerësimi i stafit akademik të jetë i qasshëm publikisht.</i>	Së fundi, (në Nëntor, 2021) në UP është mbajtur një punëtori dy ditore midis menaxhmentit të UP-ës dhe HERAS+ (ekspertë ndërkombëtarë) për mundësinë e përpilimit dhe implementimit të udhërrëfyesit për matjen e performancës së stafit akademik të UP-ës, duke përfshirë kartelën vlerësuese të performancës në katër fusha kryesore me rëndësi për UP-ën: mësime, hulumtim, zhvillim institucional dhe shërbim të komunitetit (https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1.37.1510). Sot, stafi akademik i programit BScIA sikur edhe i tërë stafi i FN-ës i nënshtrohet vetëvlerësimit dhe pyetësorëve nga ana e personelit akademik, (ashtu sic kërkohet të definohet edhe në Formularët e Komisionit Vlerësues për Emërimin e Personelit Akademik, për marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor të Lartë, që gjendet në rregulloren për emërimin dhe avancimin e stafit), përfshirë vlerësimin e stafit për aktivitete arsimore (mësime, organizim të vizitave studimore, ftesë të ligjëruesve vizitor, literaturë dhe mekanizma për vlerësim të mirëfillt të studentëve), për aktivitete hulumtuese, shkencore dhe profesionale (publikime në revista shkencore me recension ndërkombëtar, pjesëmarrje në konferenca shkencore, pjesëmarrje në projekte hulumtuese, shkencore dhe profesionale, recensione në revista akademike dhe profesionale) si dhe për aktivitete shërbyese për UP-ën, FN-ën dhe për komunitetin (detyra të caktuara nga niveli i UP-ës, FN-ës, apo në baza vullnetare).	Në vazhdimësi. Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës.
1.4 Përbajtja e procesit arsimor – Plotësisht i përbushur		
<i>In the Geodesy MSc program the inclusion of 3D scanning technology and remote sensing theory should be considered in the future.</i>	Teknologjia e skanimit 3D është përfshirë në lenden Gjeodezia Inxhinierike (përfshirë minierat), ku është përmirësuar syllabusi i lëndës duke përfshirë skanimin 3D laserik. Remote sensing është përfshirë në lëndët: a) GIS në mjedis dhe hulumtimet nga largësia, dhe b) Vrojtimi i Tokës	
1.5 Studentët – Plotësisht i përbushur		
<i>Të zhvillohet një grup treguesish cilësor duke iu referuar regjistrimit të normës së përfundimit të lëndës dhe programit për student.</i>	Është vendimi i studimeve themelore-bachelor, i cili definon politikat e progresit të studentëve. Duke u përbajtur në këtë vendim, stafi administrativ i FN-ës zhvillon evidentimin e progresit të studentit nga viti në	Në vazhdimësi. Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës.

	<p>vit deri te diplomimi. Sipas vendimit mbi kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve themelore-bachelor, studentët, vitin e dytë të studimeve mund t' a regjistrojnë nëse kanë të përfunduara 60% të lëndëve mësimore të vitit të parë të studimeve. Ndërsa, vitin e tretë të studimeve mund t' a regjistrojnë nëse kanë të përfunduara 50% të lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.</p>	
<p><i>Të zhvillohet një plan veprues për të redukuar numrin e braktisjes dhe për të rritur numrin e të diplomuarve në programe.</i></p>	<p>Në programin studimor MScGJ deri më tani nuk ka student i cili ka braktisur studimet. Përndryshe është strategjia e FN-ës që parashih iniciativën për zhvillim të qëndrueshëm të performancës së programeve të studimeve duke rritur numrin e studentëve në FN. Megjithatë, FN-ja duke qenë syhapur në numrin e studentëve që aplikojnë në programet e studimit në përgjithësi dhe në programin BScIA, ka paraparë edhe në Planin Strategjik që të organizojë fushata për sensibilizim të studentëve të ardhshëm, të publikojë broshura njoftuese, të informojë në kohë relae nga tregu i punës për performancën e programit të studimit. Në vitin akademik 2021/2022, këto procese veç se janë aplikuar nga FN-ja duke rezultuar pozitivisht në thirrje të kandidatëve për regjistrim në programe të FN-ës.</p> <p>FN-ja në vazhdimësi shpall tri afate të rregullta publike në përputhje me Nenin 111 të Statutit të UP-ës, dhe atë: afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe afatin e vjeshtës (shtatorit). Oraret për secilin afat provimi shpallen nga menaxhmenti i FN-ës, fizikisht në “dritaret” e FN-ës dhe në mënyrë elektronike në faqe të FN-ës, të “Oraret”. Po ashtu, për studentë të UP-ës, gjegjësisht FN-ës, me qëllim të arritjes së diplomimit në kohë, organizohen edhe afate plotësuese në shërbim të studentëve të rregullt dhe studentëve apsolvent.</p> <p>Po ashtu, komponentë me rëndësi në shërbim të studentëve (me qëllim edhe të promovimit të studimeve në UP) është edhe Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) e cila ka për qëllim që të ofrojë mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit, ndërmjetësimit me punëdhënësin, ofrimit të këshillave akademike dhe aktiviteteteve të tjera. Informatat për aktivitetet, pjesë e të cilave mund të jenë edhe studentët e edhe të diplomuarit, u përcillen me e-mail nga QZHK. Edhe FN-ja në kuadër të kësaj qendre posedon faqen “e-Karriera”, përmes së cilës studentët mund të njoftohen për informatat e fundit rreth trajnimeve, punëve praktike, panairëve, këshillave dhe aktiviteteteve të tjera.</p>	<p>Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës dhe Shefi i departamentit.</p>

<p><i>Të zhvillohen nxitje (shtytje, joshje) për të inkurajuar studentët që të përfundojnë studimet në kohë dhe të marrin diplomat e tyre me të përfunduar programin sipas periudhës zyrtare.</i></p>	<p>Nga vlerësimet e ekspertëve të kaluar, është vlerësuar se, “kurrikula e propozuar lejon kohë të mjaftueshme për student në semestrin e fundit (semestrin VI) për punë të pavarur dhe për finalizim të studimit”.</p> <p>Edhe çështjet rreth rekomandimeve paraprake në lidhje me përfundimin e studimeve inkurajojnë studentët të përfundojnë në kohë studimet. Megjithatë, rregullorja për studime bachelor së fundi është modifikuar dhe pritet vec se të miratohet nga Senati i UP-ës. Kjo rregullore (e modifikuar) i jep të drejtën dhe i lehtëson studentit që temen e diplomës t’a përfundojë brenda afatit të studimeve.</p>	<p>Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës dhe Shefi i departamentit.</p>
1.6 Hulumtimi–Në thelb i përmbushur		
<p><i>Të krijohet një strategji më e detajuar dhe plan zhvillues për fakultetin, duke specifikuar përfshirjen e secilit departament, me theks bashkëpunimet dhe sinergjitë e mundshme. Secili program studimor duhet të përfshihet në planin e zhvillimit hulumtues, duke dhënë drejtim spesifik dhe real.</i></p>	<p>Objektivë strategjike e FN-ës, ndër të tjera është edhe avancimi i kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore në nivel ndërkombëtar. FN-ja, gjegjësisht departamenti i Gjeodezisë veç se është aplikues me një projekt propozim në programin “HORIZON-WIDERA-2021-ACCESS-02” (Acronym: RS4LAWA; Number: 101059976; Duration: 36 months) në të cilin janë paraparë edhe bashkëpunimet midis departamenteve Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit e edhe përfshirje e studentëve nga të dyja departamentet. Në UP, këtë fund vit (2021) planifikohet edhe ndarja e buxhetit për hulumtime për njësi akademike. Në kuadër të kësaj, FN-ja në koordinim me departamentet brenda saj është kërkuese e një buxheti mirë të planifikuar, që do të mbështesë komponentën e hulumtimeve shkencore në FN-ja. Nga ky buxhet (që parashihet për vitet në vijim), përfitues do të jenë të gjitha programet e studimit të FN-ës, me plan të një projekti me përfshirje të të gjitha departamenteve.</p>	<p>Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës.</p>
<p><i>Menaxhmenti i Fakultetit duhet në mënyrë efektive të përkrahë departamentet dhe stafin për të krijuar dhe për të kryer (zbatuar) projektet shkencore, në përputhje me planin zhvillues për hulumtime.</i></p> <p><i>Fakulteti duhet të krijojë strategji publikimesh brenda kornizës së strategjisë hulumtuese. Përderisa, standardet e AKA-s vënë theksin në aktivitet publikimi, fakulteti duhet të marrë në konsideratë këtë si një çështje të rëndësishme strategjike në procedurat e riakreditimit në të ardhmen.</i></p>	<p>Nisur nga iniciativa strategjike e FN-ës [S3], e cila ka të bëjë me rritjen e kapaciteteve për kërkime shkencore përmes bashkëpunimeve institucionale ndërkombëtare, e që synon t’a implementojë gjatë periudhës kohore 2021 – 2023, këtë vit (2021), stafi akademik dhe departamentet e FN-ës janë përfitues të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar nga UP-ja dhe Agjencioni Zvicëran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) si financuese e programit për të implementuar programin e nivelit master të studimeve (MSc) “Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë”. Në kuadër të kësaj, projekti për implementim të programit ka të ndarë edhe komponentën e hulumtimeve me partnerë vendor (Institucione nga UP dhe jashtë UP) dhe ndërkombëtar (shih vegzën: https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1.37.1488)</p> <p>Përderisa në rregulloren mbi emërimin dhe avancimin e personelit akademik, janë të</p>	<p>Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës.</p>

	definuara platformat për publikime të punimeve, hulumtimev, edhe stafi i FN-ës në vazhdimësi i përmbahet dispozitave të theksuara në këtë rregullore.	
1.7 Infrastruktura dhe burimet – Pjesërisht të përmbushura		
<i>Përmirësoj kushtet e bibliotekës</i>	FN-ja në periudhën kohore 2021 -2023, si iniciativë strategjike për implementim ka edhe rritjen e numrit të ulëseve në bibliotekën e fakultetit dhe në përgjithësi kushtet e bibliotekës, përfshirë edhe librarinë e edhe sallat e leximit.	Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës.
<i>Të krijojë plan veprues strategjik për të adaptuar infrastrukturën dhe objektin për student me nevoja të veçanta.</i>	FN-ja bashkë me dy fakultetet tjera teknike (FIEK dhe FIM) në vazhdimësi mundohen që të përshtasin infrastrukturën dhe objektet edhe për studentë me nevoja të veçanta. Tre katet e objektit mund të arrihen më një ashensor modern. Kati përdhes dhe hyrja kryesore e objektit është e qasshme për të gjitha mjetet që përdorin personat më nevoja të veçanta.	Në vazhdimësi Menaxhmenti i UP-ës, Menaxhmenti i FN-ës.

4. LISTA E REFERENCAVE



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY
Rr. Agim Ramadani, ndertesë e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-548 644 URL: <http://www.fn.uni-pr.edu> Mail: fn@uni-pr.edu

Dekani

Prof.Ass.Dr.Florim Grajçevci

Ref. nr. _____

Prishtinë _____ 2022

Për nevojat e hartimit të raporteve të vetëvlerësimit të brendshëm të riakreditimit të programeve të studimeve për BSc konstruktiv, BSc Gjeodezi, BSc Hidroteknikë, MSc Konstruktiv dhe MSc Hidroteknikë, në vazhdim janë të radhitura referencat të cilat ndihmojnë për faktet dhe mbështetjet të cilat Fakulteti i Ndërtimtarisë si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës e bazon aktivitetin e vet.

LISTË E REFERENCAVE - RAPORTI RVV

Referenca 1	Statuti i UP
Referenca 2	Monografia UP
Referenca 3	Plani Strategjik UP
Referenca 4	Kodi Etik I stafit akademik
Referenca 5	Marreveshje mes Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Fakultetit të Arkitektures
Referenca 6	Pershkrimi i Punës së Dekanit
Referenca 7	Rregullore për studimet Bachelor (BSc) UP
Referenca 8	Rregullore për studimet Master (MSc) UP
Referenca 9	Rregullore për plotësim ndryshim të nenit 25, paragr. 7 të Rregullores nr. 2-921, dt. 24.10.2019, për studimet themelore bachelor në Universitetin e Prishtinës
Referenca 10	Rregullore për plotësim-ndryshim të Rregullores nr. 2-922, dt. 24.10.2019, për studimet master shkencor në Universitetin e Prishtinës
Referenca 11	Vendim - Koordinator Florim Grajçevci
Referenca 12	Vendim - Koordinator Laura Kusari
Referenca 13	Vendim - Koordinator Figene Ahmedi
Referenca 14	Vendim - Koordinator Perparim Ahmeti
Referenca 15	Vendim - Koordinator i zhvillimit akademik Enes Krasniqi
Referenca 16	Vendim - Komisioni për studime në FN
Referenca 17	Udhëzues për temën e diplomes Bachelor
Referenca 18	Udhëzues për temën e diplomes Master
Referenca 19	Vendim për vazhdimin e afatit të diplomimit BSc MSc dhe PhD
Referenca 20	Rregullore mbi emerimin, riemerimin dhe avancimin e personelit akademik UP 2019
Referenca 21	Rregullore mbi emerimin, riemerimin dhe avancimin e personelit akademik UP 2018
Referenca 22	Rregullore e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkpunëtorëve të jashtëm UP
Referenca 23	Raport i komisionit vlerësues për angazhim për bashkpunëtorë të jashtëm
Referenca 24	Deklarate mbi parandalimin e nepotizmit në UP
Referenca 25	Rregullore e punës së sistemit elektronik për menaxhimin e studenteve SEMS
Referenca 26	Vendim - Caktimi i mbikqyresit të asistentëve të autorizuar për ligjerata
Referenca 27	Vendim - Emerimi i eksperteve për lenden e gjykates
Referenca 28	Vendim - Emerimi i komisionit për Ekuivalentim dhe Barazvlerë të FN
Referenca 29	Miratimi i rregullores - Plotësim Ndryshimi i rregullores nr.163 15.1.2015 - Trupa Keshill-dhenese e njesive akademike UP
Referenca 30	CV Template e Stafit Akademik
Referenca 31	Kontrata e punës Template
Referenca 32	Kontrata për angazhim me honorar Template
Referenca 33	Kontrata për angazhim me mbinorme Template
Referenca 34	Rregullore për sigurimin e cilesise dhe vleresimit UP

Referenca 35	Kronika Kombetare e Kualifikimeve
Referenca 36	Udhzues per vleresimin e lendeve nga studentet dhe perdorimi i rezultateve te tyre ne UP
Referenca 37	Rregullore per proceduren e zgjedhjeve te studenteve
Referenca 38	Rregullore për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore - Shkencore, Artistike dhe Sportive në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" 3-879, 11.12.2020
Referenca 39	Zgjatje e periudhes se akreditimit per programet e Studimit te UP - FN dhe FA
Referenca 40	Vendimi i Menaxherit të Kontrates dhe vendimi i Komisionit te Pranimit
Referenca 41	Njoftim per Kontratë - Furnizim me pajisje laboratorike per FIEK dhe te tjera
Referenca 42	Njoftim per Kontratë - Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve laboratorike per FNA-në
Referenca 43	Dosja e Tenderit- Shqip Furnizim me pajisje Laboratorike për FIEK dhe FNA
Referenca 44	Dosja e Tenderit-Shqip Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve Laboratorike për FNA-së
Referenca 45	Kontrata dhe Oferta Financiare-Lot-2
Referenca 46	Kërkesa - Furnizim me pajisje Laboratorike për FNA - Ritender
Referenca 47	Lista e Stafit Akademik Hidroteknikë
Referenca 48	Lista e Stafit Akademik Konstruktiv
Referenca 49	Planifikimi i prokurimit paraprak - buxheti per vitin 2021
Referenca 50	Kerkese rektoratit lidhur me buxhetin e vitit 2021, 22 nga FN, FIM, FIEK
Referenca 51	Kerkesat dhe Formularet
	Fleteregjistrim
	Kerkesat per studente
	Formulari F1B Kerkese per caktimin e mentorit BSc
	Formulari F2B_Raporti per aprovimin, formimin e komisionit dhe mbrojtjen e punimit te diplomes BSc
	Kerkese per terheqjen e punimit te diplomes dhe vendimi per mbrojtje BSc
	Formulari F1 Kerkese per vleresimin e projekt propozimit te temes se diplomes MSc
	Formulari F1 Raporti i vleresimit te Projekt Propozimit MSc
	Formulari F2_Kerkese per Formimin e Komisioni per vleresimin e temes se Diplomes MSc
	Formulari F3 Raporti i vleresimit te temes se diplomes MSc
	Formulari F4 Formulari per mbrojtjen e temes se diplomes MSc
Referenca 52	Pyetesoret
	Pyetësor për personelin akademik Shqip
	Pyetësor për personelin akademik English
	Pyetësori për vlerësimin e lëndës Shqip
	Pyetësori për vlerësimin e lëndës English
	Pyetesori per studentet e nivelit Bachelor Shqip
	Pyetesori per studentet e nivelit Bachelor English
	Pyetësor për personelin administrativ dhe mbështetës të universitetit Shqip
	Pyetësor për personelin administrativ dhe mbështetës të universitetit English
Referenca 53	Template, Certifikatë e trajnimit të stafit akademik
Referenca 54	Rregullorja për mobilitet akademik të studentëve në Universitetin e Prishtinës
Referenca 55	Buxheti i planifikuar 2021,2022,2023
Referenca 56	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 3
Referenca 57	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 4
Referenca 58	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 5
Referenca 59	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 7
Referenca 60	Suterreni-Labororet dhe Salla Mesimi
Referenca 61	Perdhesa-Labororet dhe Salla Mesimi
Referenca 62	Labororet dhe Salla Mesimi -Kati 1
Referenca 63	Learning agreement Student Mobility for Studies

5. SHTOJCAT

5.1. Studentët – të dhënat

Tabela 1. Numri i studenteve aktual ne Programet e FN-së

	Baçelor			Master			Gjithsej		
	total	F	M	total	F	M	total	F	M
<i>Konstruktiv</i>	582	123	459	125	25	100	707	148	559
<i>Hidroteknike</i>	142	35	107	55	21	34	197	56	141
<i>Gjeodezi</i>	180	37	143	51	20	31	231	57	174
<i>Inxhinieri e Ambientit</i>	87	60	27				87	60	27
<i>Infrastruturë Rrugore</i>				6	6	0	6	6	0
TOTALI	991	255	736	237	72	165	1228	327	901

Tabela 2. Numri i studenteve dhe te diplomuarve ne tre vitet e fundit

	Viti	BAÇELOR		MASTER	
		Studentë	Të Diplomuar	Studentë	Të Diplomuar
KONSTRUKTIV	2019	109	72	24	14
	2020	77	59	31	20
	2021	97	66	39	15
HIDROTEKNIKË	2019	26	42	14	3
	2020	16	14	7	8
	2021	17	31	20	9
GJEODEZI	2019	38	63	19	1
	2020	51	34	20	2
	2021	38	20	19	5
INFRASTRUKTURE RRUGORE	2019	0		0	2
	2020	0		0	5
	2021	0		0	1
INXHINIERI E AMBIENTIT	2019	7	7		
	2020	25	11		
	2021	16	20		

Tabela 3. Numri i studenteve qe i braktisin studimet (drop-out) për tri vitet e fundit

Niveli i studimeve	2017/18	2018/19	2019/20	2020/21
Niveli Bsc	23	15	19	7
Niveli Master	4	2	0	0
Niveli PhD				

5.2. Hapësirat dhe paisjet

Tabela 4. Infrastruktura e FN-se, sipërfaqet e objekteve

	DESTINIMI I HAPËSIRËS	SASIA	SIPËRFAQJA (m ²)
1	SALLA MËSIMI	21	1,450.00 m ²
2	LABORATORET	5	1,780.00 m ²
3	AMFITEATRI	2	508.00 m ²
4'	Hapësira përcjellëse të laboratoreve (kabinet, sallë mësimi* dhe depo)	6*	1,589.00 m ²
4	KABINETE	26	379.00 m ²
5	ADMINISTRATA	8	182.00 m ²
6	Laboratorë kompjuterash	3	240.00 m ²
7	Korridore + nyje sanitare + hapësira ndihmëse+ nyje sanitare shtese		2,397.00 m ²
GJITHSEJ SIPERFAQE PER DEPARTAMENTET NE OBJEKTIN E FAKULTETIT TE NDERTIMTARISE DHE LABORATORE			8,525.00 m²

Tabela 5. Infrastruktura e FN-se, Mjetet e konkretizimit, Pajisjet, Labororet e FN-se

	PAJISJET	SASIA
1	PROJEKTORËT	24
2	MJETET E KONKRETIZIMIT	54
3	APARATURA LABOATORIKE, (I-materialet)	150
4	APARATURA LABORATORIKE, (II-asfalti)	32
5	APARATURA LABORATORIKE,(Hidroteknikë)	20
6	APARATURA LABORATORIKE, (Master në Gjeodezi)	40
7	APARATURA LABORATORIKE, (Eficienca e Energjisë)	20
8	APARATURA LABORATORIKE, (III-Gjeomekanike)	70

Tabela 6. Infrastruktura e FN-se, Librat e evidencave, libra tame.

	LIBRAT	SASIA
1	REGJISTRI FIZIK I LIBRAVE	>150
2	REGJISTRI ELEKTRONIK I LIBRAVE	100

Verejtje: Qe nga viti 1961 Fakulteti i Ndertimtarise organizon studime te niveleve te ndryshme dhe ne cdo gjenerate te studenteve jane shenimet e ruajtura ne libra tame. Ne evidencat tona egzistojne me shume se 150 libra ame te arhivuara. Te gjitha librat e regjistrave kete vit (2021/2022) kan filluar te skanohen dhe te ruhen si dokumente elektronike.

Tabela 7. Infrastruktura e FN-se, Librat e evidencave, libra tame.

	INFRASTRUKTURA E IT	SASIA
1	INTERNET (WI FI)	Ne te gjitha hapesirat
2	NUMRI I PC PËR STAF AKADEMIK	50
3	NUMRI I PC PËR STUDENTË	95
4	NUMRI I PC PËR ADMINISTRATË	20
5	PRINTERA	50
6	TELEFONA FIKS	6
7	APARATET FOTOKOPJUESE	5

5.3. Plani i Buxhetit dhe financimi për FN dhe FA

Plani i buxhetit dhe i financimit (llogaritë e të hyrave, shpenzimeve kapitale, shpenzimet per hulumtime dhe shpenzimet per mjete te konkretizimit) ne nivel te Njësisë akademike/Institucionit ne përgjithësi, për së paku tri vitet e ardhshme:

Tabela 8. Pasqyrat Buhetore te FN-se, Planifikimi buxhetor sipas viteve.

PERSONELI PAGAT DHE MEDITJET	Numri i Punëtorëve të Aprovuar 2022	Planifikimi i Buxhetit për 2020		Planifikimi i Buxhetit për 2021		Planifikimi i Buxhetit për 2022	
Profesor i rregullt	3	7	267,201	8	293,921	9	323,314
Profesor i asocuar	6	8	119,924	9	131,917	10	145,108
Profesor asistent	10	17	75,892	18	83,481	19	91,829
Lektor	1	1	24,045	2	26,450	3	29,095
Asistent	18	20	286,287	21	314,915	22	346,407
Administratë	11	12	109,147	13	120,061	14	132,067
Bashkepunore	28	30	416,782	31	458,460	32	504,306
TOTALET E STAFIT DHE SHPENZIMEVE PËR PAGA & MËDITJE	127	95	1,299,278 €	102	1,429,206 €	109	1,572,126 €

Tabela 9. Pasqyrat Buhetore te FN-se, Planifikimi buxhetor sipas viteve.

SHPENZIMET NE KATEGORITE TJERA EKONOMIKE	Planifikimi i Buxhetit për 2020	Planifikimi i Buxhetit për 2021	Planifikimi i Buxhetit për 2022
MALLRA E SHËRBIME	448,270.00 €	473,097.00 €	520,407.00 €
SHPENZIME KOMUNALE	77,000.00 €	84,700.00 €	93,170.00 €
SHPENZIME KAPITALE	1,705,700.00 €	1,876,270.00 €	2,226,270.00 €
TOTALET E SHPENZIMEVE NË KATEGORITË TJERA EKONOMIKE	2,230,970.00 €	2,434,067.00 €	2,839,847.00 €
SHPENZIMET TOTALE DHE STAFI	3,530,248.00 €	3,863,272.86 €	4,411,973.00 €

5.4 Struktura e Aneksve te bashkelidhura ne format elektronik (per verzionin final te RVV-se ne CD)

UP-FN-2021 (*Folder-i kryesor*)

1_Dokumente

- 01-Aneks-Faqja e pare-Aplikacioni
- 02-1-RVV-UP-FN-riakreditim-Inxhinieri e Ambientit
- 02-1-RVV-UP-FN-riakreditim-Gjeodezi
- 03-Aneks-FN-Plani i zbatimit te rekomandimeve
- 04-Aneks-Puna dhe Projektet shkencore
- 05-Aneks-Marreveshje Bashkëpunimi
- 06-Aneks-Lista e referencave

2_CV

CV-BSc Inxhinieri e Ambientit (*te gjitha CV-te e Personelit mesimor ne Program*)

CV-MSc Gjeodezi (*te gjitha CV-te e Personelit mesimor ne Program*)

3_Syllabuse

Syllabuse- BSc Inxhinieri e Ambientit (*te te gjitha lendeve ne Planin mesimor te Programit*)

Syllabuse- MSc Gjeodezi (*te te gjitha lendeve ne Planin mesimor te Programit*)